

BlueHelix ALPHA C





- Lexoni me kujdes paralajmërimet që përmban ky udhëzues, pasi ofrojnë udhëzime të rëndësishme për sigurinë e instalimit, të përdorimit dhe të mirëmbajtjes.
- Ky udhëzues përbën një pjesë integrale dhe të rëndësishme të produktit dhe duhet të ruhet nga përdoruesi me kujdes për çdo referim të mëtejshëm.
- Nëse pajisja duhet të shitet apo të transferohet tek një tjetër zotërues ose nëse duhet të zhvendoset, sigurohuni gjithmonë që udhëzuesi të jetë gjithmonë pranë kaldajës, në mënyrë që zotëruesi i ri dhe/ose instaluesi të mund t'i referohet.
- Instalimi dhe mirëmbajtja duhet të kryhen në përputhje me normat në fuqi, sipas udhëzimeve të ndërtuesit dhe duhet të kryhen nga persona të kualifikuar profesionalisht.
- Një instalim i gabuar ose një mirëmbajtje jo e duhur mund të shkaktojnë dëme në persona, kafshë ose objekte. Përfshihet çdo lloj përgjegjësie nga ndërtuesi për dëmet e shkaktuara nga gabime në instalim dhe në përdorim, si dhe për shkak të mosrespektimit të udhëzimeve nga vetë ndërtuesi.
- Përpara se të kryeni çdo proces pastrimi ose mirëmbajtjeje, shkëputeni pajisjen nga rrjeti i ushqimit duke shtypur çelësin e impiantit dhe/ose përmes mekanizma-

	Ky simbol do të thotë " Kujdes " dhe është vendosur në gjithë paralajmërimet që lidhen me sigurinë. Lutemi përmbajuni me përpikëri këtyre udhëzimeve, për të shmangur rreziqe dhe dëme tek personat, kafshët dhe sendet.
	Lutemi përmbajuni me përpikëri këtyre udhëzimeve, për të shmangur rreziqe dhe dëme tek personat, kafshët dhe sendet.



Shenja CE vërteton që produktet përmbushin kushtet themelore të direktivave përkatëse në fuqi..

Deklaratën e konformitetit mund t'ia kërkonti prodhuesit.

VENDET E SHITJES: AL



ve të posaçëm të ndërprerjes së energjisë.

- Në rast defekti dhe/ose keqfunksionimi të pajisjes, çaktivizojeni atë, duke mos bërë asnjë përpjekje riparimi ose ndërhyrjeje të drejtpërdrejtë. Drejtojuni vetëm personelit të kualifikuar profesionalisht. Riparimi/zëvendësimi i mundshëm i produkteve duhet të kryhet vetëm nga persona të kualifikuar profesionalisht, duke përdorur vetëm pjesë këmbimi origjinale. Mosrespektimi i sa më sipër mund të komprometojë sigurinë e pajisjes.
- Për të garantuar funksionimin e mirë të pajisjes është e domosdoshme që persona të kualifikuar të kujdesen për një mirëmbajtje periodike.
- Kjo pajisje duhet të përdoret vetëm për përdorimin e parashikuar. Çdo përdorim tjetër konsiderohet i papërshtatshëm dhe si pasojë, i rrezikshëm.
- Pas heqjes së ambalazhit, sigurohuni që përmbajtja e tij të jetë e plotë. Elementët ambalazhues nuk duhet të jenë të arritshëm nga fëmijët, pasi janë burime të mundshme rreziku.
- Pajisja mund të përdoret nga fëmijë jo më të vegjël se 8 vjeç dhe nga persona me aftësi të kufizuara fizike, ndjesore ose mendore, si dhe pa përvojën dhe njohuritë e duhura, për sa kohë janë të mbikëqyrur apo pasi janë udhëzuar si duhet për përdorimin e sigurt të pajisjes ose u janë shpjeguar rreziqet që lidhen me të. Fëmijët nuk duhet të luajnë me pajisjen. Pastërtia dhe mirëmbajtja që normalisht kryhet nga përdoruesi, mund të kryhet edhe nga fëmijë jo më pak se 8 vjeç, me kusht që të jenë të mbikëqyrur.
- Në rast dyshimi, mos e përdorni pajisjen dhe drejtojuni shitësit.
- Mënjanimi i pajisjes dhe aksesorëve të saj duhet të kryhet në mënyrën e duhur, sipas normave në fuqi.
- Figurat e paraqitura në këtë manual janë një paraqitje e thjeshtuar e produktit. Në këtë paraqitje mund të ketë ndryshime të vogla dhe jo domethënëse nga produkti që keni marrë në dorëzim.



1 Udhëzime përdorimi	5
1.1 Prezantimi	5
1.2 Paneli i kontrollit	5
1.3 Lidhja me rrjetin elektrik, ndezja dhe fikja	6
1.4 Rregulloret	8
2 Instalimi	12
2.1 Dispozita të përgjithshme	12
2.2 Vendi i instalimit	12
2.3 Lidhjet hidraulike	12
2.4 Lidhja e gazit	14
2.5 Lidhjet elektrike	14
2.6 Kanalet e tymrave	17
2.7 Lidhja e tubit të shkarkimit të kondensimit	24
3 Shërbimi dhe mirëmbajtja	25
3.1 Rregulloret	25
3.2 Vënia në punë	33
3.3 Mirëmbajtja	34
3.4 Zgjidhja e problemeve	36
4 Karakteristikat dhe të dhënat teknike	40
4.1 Dimensionet dhe bashkimet	40
4.2 Pamja e përgjithshme	42
4.3 Qarku hidraulik	42
4.4 Tabela e të dhënave teknike	43
4.5 Diagrama	44
4.6 Skema elektrike	45

1. Udhëzime përdorimi

1.1 Prezantimi

I nderuar klient,

BlueHelix ALPHA C është një gjenerator termik me **shkëmbyes prej çeliku të pandryshkshëm (inoksi)** me prodhim uji shtëpiak të integruar, **me përzjerje paraprahe me kondensim** me rendiment të lartë dhe nivel të ulët emetimesh, funksionon me **gaz natyror (G20)**, **gaz të lëngët (G30-G31)** ose me **ajër të propanuar (G230)** si dhe i pajisur me një sistem kontrolli me mikroprocesor.

Pajisja është me dhomë hermetike dhe e përshtatur për instalimin në mjedise të brendshme dhe të jashtme në një **vend pjesërisht të mbrojtur** (sipas **EN 15502**) me temperatura deri në **-5°C**.

1.2 Paneli i kontrollit




fig. 1- Paneli i kontrollit

Legjenda e panelit fig. 1

- 1 Butoni zbritës i rregullimit të temperaturës së ujit të ngrohtë shtëpiak
- 2 Butoni rritës i rregullimit të temperaturës së ujit të ngrohtë shtëpiak
- 3 Butoni zbritës i rregullimit të temperaturës së impiantit të ngrohjes
- 4 Butoni rritës i rregullimit të temperaturës së impiantit të ngrohjes
- 5 Ekran
- 6 Butoni Risistemim - Menuja "Temperaturë e ndryshueshme"
- 7 Butoni i zgjedhjes së modalitetit "Dimër", "Verë", "pajisja OFF", "ECO", "COMFORT"
- 8 Treguesi i modalitetit Eco (ekonomik) ose Comfort (Komfort)
- 9 Treguesi i funksionimit të modalitetit shtëpiak
- 10 Treguesi i modalitetit të dimrit
- 12 Treguesi shumëfunksional
- 13 Treguesi i funksionit të ngrohjes
- 14a Treguesi i djegësit të ndezur (pulson gjatë funksionit të kalibrimit dhe fazave të autodiagnostikimit)
- 14b Shfaqet kur verifikohet një anomali që ka shkaktuar bllokimin e pajisjes. Për të risistemuar funksionimin e pajisjes duhet të shtypni buronin **RISISTEMIM** (pjesa 6)
- 17 Sensori i jashtëm i identifikuar (me sondë të jashtme opsionale)

Treguesi gjatë funksionimit

Ngrohja

Kërkesa për ngrohje (e gjeneruar nga termostati i ambientit ose nga kronokomanda) sinjalizohet nga aktivizimi i radiatorit.

Ekran (pjesa 12 - fig. 1) shfaq temperaturën aktuale të prurjes së ngrohjes dhe gjatë kohës së pritjes për ngrohjen, shfaq shkrimin "d2".




fig. 2

Shtëpiak

Kërkesa për ujë shtëpiak (e gjeneruar nga hapja e ujit të ngrohtë shtëpiak) sinjalizohet nga ajri i ngrohtë i rubinetit.

Ekrani (pjesa 12 - fig. 1) shfaq temperaturën aktuale të daljes së ujit të ngrohtë shtëpiak dhe gjatë kohës së pritjes për ujit shtëpiak, shfaq shkrimin “d1”.




fig. 3

Komfort

Kërkesa për Komfort (risistemim i temperaturës së brendshme të kaldajës) sinjalizohet nga pulsimi i simbolit **Komfort**. Ekrani (pjesa 12 - fig. 1) shfaq temperaturën aktuale të ujit që përmban kaldaja.

Anomalia

Në rast anomalish (shih cap. 3.4) ekrani do të shfaqë kodin e defektit (pjesa 12 - fig. 1) dhe gjatë periudhave të pritjes së sigurisë, shfaq shkrimin “d3” dhe “d4”.

1.3 Lidhja me rrjetin elektrik, ndezja dhe fikja

Kaldaja nuk ushqehet me energji



Gjatë ndërprerjeve të gjata të punës në periudhën e dimrit, për të shmangur dëme të mundshme nga ngrirja, rekomandohet të shkaktohet i gjithë uji i kaldajës.



fig. 4- Kaldaja nuk ushqehet me energji

Kaldaja ushqehet me energji

Ushqeheni kaldajën me energji.



fig. 5- Ndezja / versioni i softuerit




fig. 6- Shfryrja me ventilator aktiv




fig. 7- Shfryrja me ventilator të fikur

- Gjatë 5 sekondave të para, në ekran shfaqet versioni i softuerit të skedës(fig. 5).
- Për 20 sekondat e ardhshme, në ekran shfaqet **FH** që identifikon ciklin e shfryrjes së ajrit nga impianti i ngrohjes me ventilatorin në funksion (fig. 6).
- Në 280 sekondat e ardhshme, cikli i shfryrjes vazhdon me ventilator të fikur (fig. 7).
- Hapni rubinetin e gazit në rrjedhën e sipërme të kaldajës
- Kur zhduket shkrimi **Fh**, kaldaja është gati për funksionim automatik sa herë që të hapet uji i ngrohtë shtëpiak ose kur ka një kërkesë në termostatin e ambientit

Fikja dhe ndezja e kaldajës

Mund të kaloni nga një modalitet në tjetrin duke shtypur butonin **dimër/verë/off**, për rreth një sekondë, duke ndjekur hapat e paraqitur në fig. 8.

A = Modaliteti **Dimër**

B = Modaliteti **Verë**

C = Modaliteti **Off**

Për të fikur kaldajën, shtypni disa herë butonin **dimër/verë/off** (pjesa 7 - fig. 1) derisa në ekran të shfaqen pikat.




fig. 8- Fikja e kaldajës

Kur kaldaja fiket, skeda elektronike vazhdon të ushqehet me energji. Funkzioni i ujit shtëpiak dhe i ngrohjes janë çaktivizuar. Mbetet aktiv vetëm sistemi kundër ngrirjes. Për të rindezur kaldajën, shtypni sërish butonin **dimër/verë/off** (pjesa 7 - fig. 1).




fig. 9

Kaldaja do të jetë menjëherë gati në modalitetin e dimrit dhe të ujit shtëpiak.



Nëse shkëputni ushqimin elektrik dhe/ose me gaz të pajisjes, sistemi kundër ngrirjes nuk do të funksionojë. Gjatë ndërprerjeve të gjata të punës në periudhën e dimrit, për të shmangur dëme të mundshme nga ngrirja, rekomandohet të shkaktohet i gjithë uji i kaldajës, ai shtëpiak dhe ai i impiantit, ose të shkarkohet vetëm uji shtëpiak dhe të shtohet antifrizi i posaçëm në impiantin e ngrohjes, siç përshkruhet në sez. 2.3.

SHËNIM - Nëse në ekran shfaqet ikona e dimrit dhe janë të pranishëm edhe numrat shumëfunkcionalë, kaldaja është në modalitetin **"Dimër"**.

1.4 Rregulloret

Ndërçelja në dimër/verë

Shtypni butonin **dimër/verë/off** (pjesa 7 - fig. 1) derisa të zhduket ikona **dimër** (pjesa 10 - fig. 1): kaldaja do të shpërndajë vetëm ujë shtëpiak. Mbetet aktiv vetëm sistemi kundër ngrires.



fig. 10

Për të riaktivizuar modalitetin e dimrit, shtypni 2 herë butonin **dimër/verë/off** (pjesa 7 - fig. 1).



fig. 11

Rregullimi i temperaturës së ngrohjes

Shtypni butonat e ngrohjes (pjesa 3 dhe 4 - fig. 1) për ta ndryshuar temperaturën nga një minimum 20°C në një maksimum prej 80°C.




fig. 12

Rregullimi i temperaturës së ujit shtëpiak

Shtypni butonat e ujit shtëpiak (pjesa 1 dhe 2 - fig. 1) për ta ndryshuar temperaturën nga një minimum 40°C në një maksimum prej 55°C.



Me prurje të ulët dhe/ose me rritje të temperaturës së hyrjes së ujit shtëpiak, temperatura në dalje e ujit të ngrohtë shtëpiak mund të ndryshojë nga temperatura e konfiguruar.




fig. 13

Rregullimi i temperaturës së ambientit (me termostat ambientit opsional)

Përmes termostatit të ambientit, rregulloni temperaturën e dëshiruar në brendësi të lokaleve. Në rast se nuk është i pranishëm termostati i ambientit, kaldaja parashikon ruajtjen e temperaturës së impiantit në vlerën e referimit që dërgon impianti.

Rregullimi i temperaturës së ambientit (me kronokomandë opsionale)

Me anë të kronokomandës, vendosni temperaturën e dëshiruar të ambientit në brendësi të dhomave. Kaldaja do të rregullojë ujin e impiantit, në funksion të temperaturës së kërkuar të ambientit. Për sa i përket funksionimit me kronokomandën, referojuni manualit përkatës të përdorimit.

Zgjedhja e modalitetit ECO/COMFORT

Pajisja ka një funksion që garanton një shpejtësi të lartë të shpërndarjes së ujit të ngrohtë shtëpiak dhe komfort maksimal për përdoruesin. Kur mekanizmi është aktiv (modaliteti **COMFORT**), uji që përmban kaldaja ruhet në temperaturë konstante, duke mundësuar kështu disponueshmërinë e menjëhershme të ujit të ngrohtë nga dalja e kaldajës me hapjen e rubinetit të ujit, duke shmangur kohët e pritjes.

Mekanizmi mund të çaktivizohet nga përdoruesi (modaliteti **ECO**) duke shtypur butonin **dimër/verë/off** (pjesa 7 - fig. 1) për 5 sekonda. Në modalitetin **ECO**, në ekran aktivizohet simboli **ECO** (pjesa 12 - fig. 1). Për të aktivizuar modalitetin **COMFORT**, shtypni sërish butonin **dimër/verë/off** (pjesa 7 - fig. 1) për 5 sekonda.

Temperaturë e ndryshueshme

Kur instalohet sonda e jashtme (opsionale), sistemi i rregullimit të kaldajës punon me “temperaturë të ndryshueshme”. Në këtë modalitet, temperatura e impiantit të ngrohjes rregullohet sipas kushteve klimaterike të jashtme, në mënyrë që të garantojë më shumë komfort dhe kursim të energjisë gjatë gjithë periudhës së vitit. Veçanërisht, me rritjen e temperaturës së jashtme zvogëlohet temperatura e prurjes së impiantit, sipas një “grafiku kompensimi” të caktuar.

Me rregullimin e “**Temperaturës së ndryshueshme**”, temperatura e vendosur me anë të butonave të ngrohjes (pjesa 3 dhe 4 - fig. 1) kthehet në temperaturën maksimale të prurjes së impiantit. Rekomandohet të vendosni vlerën maksimale për t'i mundësuar sistemit të rregullohet brenda gjithë gamës së nevojshme të funksionimit.

Kaldaja duhet të rregullohet në fazën e instalimit nga personel i kualifikuar. Përshtatjet e mundshme mund të bëhen në çdo rast nga përdoruesi, për një komfort edhe më të lartë.

Grafiku i kompensimit dhe zhvendosja e grafikëve

Duke shtypur butonin e risistemimit **reset** (pjesa 6 - fig. 1) për 5 sekonda, hyni në menunë "temperaturë e ndryshueshme"; ku do të shfaqet "CU" duke pulsuar.

Shtypni butonat e ujit shtëpiak (pjesa 1 - fig. 1) për të rregulluar grafikun e dëshiruar nga 1 në 10 sipas karakteristikës (fig. 14). Duke e vendosur grafikun në 0, rregullimi i temperaturës së ndryshueshme rezulton e çaktivizuar.

Duke shtypur butonat e ngrohjes (pjesa 3 - fig. 1) hyni në zhvendosjen paralele të grafikëve; do të shfaqet "OF" duke pulsuar. Shtypni butonat e ujit shtëpiak (pjesa 1 - fig. 1) për të rregulluar zhvendosjen paralele të grafikëve sipas karakteristikës (fig. 15).

Duke shtypur butonat e ngrohjes (pjesa 3 - fig. 1) hyni në menunë "fikja sipas temperaturës së jashtme" dhe shfaqet "**SH**" duke pulsuar. Shtypni butonat e ujit shtëpiak (pjesa 1 - fig. 1) për të rregulluar temperaturën e jashtme të fikjes. Nëse konfigurohet në 0, funksioni është i çaktivizuar, gama varion nga 1 në 40°C. Ndezja ndodh kur temperatura e sondës së jashtme është më e ulët se 2°C në krahasim me atë që është konfiguruar.

Duke e shtypur sërish butonin e risistemimit **reset** (pjesa 6 - fig. 1) për 5 sekonda, dilni nga menuja "temperatura e ndryshueshme".

Nëse temperatura e ambientit është më e ulët se sa vlera e dëshiruar, rekomandohet të vendosni një grafik me rend më të lartë dhe anasjelltas. Vijoni me rritjen ose zbritjen me nga një njësi dhe kontrolloni rezultatin në ambient.




fig. 14- Grafikët e kompensimit




fig. 15- Shembull i zhvendosjes paralele të grafikëve të kompensimit

Rregullimi nga kronokomanda



Nëse në kaldajë është lidhur kronokomanda (opsionale), rregulloret e përshkruara më parë, trajtohen siç tregohet në tabella 1.

Tabella. 1

Rregullimi i temperaturës së ngrohjes	Rregullimi mund të bëhet si nga menuja e kronokomandës, ashtu edhe nga paneli i kontrollit të kaldajës.
Rregullimi i temperaturës së ujit shtëpiak	Rregullimi mund të bëhet si nga menuja e kronokomandës, ashtu edhe nga paneli i kontrollit të kaldajës.
Ndërçelja në verë/dimër	Modaliteti i verës ka përparësi në rast se në kronokomandën bëhet një kërkesë e mundshme për ngrohje.

Zgjedhja e modalitetit Eco/Comfort	Çaktivizimi i ujit shtëpiak nga menuja e kronokomandës, kaldaja zgjedh modalitetin ekonomik. Në këto kushte, butoni eco/comfort nga paneli i kaldajës është çaktivizuar.
Temperaturë e ndryshueshme	Duke aktivizuar ujin shtëpiak nga menuja e kronokomandës, kaldaja zgjedh modalitetin Comfort. Në këto kushte, nga paneli i kaldajës mund të zgjidhet një nga dy modalitetet.
	Duke përdorur kronokomandën, bëjini gjithë rregullimet nga kjo e fundit.

Rregullimi i presionit hidraulik të impiantit

Presioni i ngarkimit me impiant të ftohtë që lexohet tek hidrometri i kaldajës (pjesa 2 - fig. 16), duhet të jetë rreth 1,0 bar. Nëse presioni i impiantit bie më poshtë se vlera minimale, kaldaja ndalon dhe në ekran shfaqet anomalia **F37**. Tërhiqni valvulin e ngarkimit (pjesa 1 - fig. 16) dhe rrotullojeni në drejtim kundër-orar për ta kthyer në vlerën fillestare. Pas përfundimit, mbylleni gjithmonë.

Pasi të jetë risistemuar presioni i impiantit, kaldaja do të aktivizojë ciklin e shfryrjes së ajrit prej 300 sekondash, të identifikuar në ekran me **Fh**.

Për të shmangur bllokimin e kaldajës, rekomandohet të kontrolloni periodikisht presionin e lexuar në manometër, me impiant të ftohtë. Në rast se presioni është më i ulët se 0,8 bar, rekomandohet ta risistemoni.

Shkarkimi i impiantit

Unaza metalike e rubinetit të shkarkimit vendoset poshtë valvulit të sigurisë që ndodhet në brendësi të kaldajës.

Për të shkarkuar impiantin, rrotulloni dorezën (ref. 3 - fig. 17) në drejtim kundër-orar për të hapur rubinetin. Mos përdorni asnjë vegël, por veproni vetëm me duar.

Për të shkarkuar vetëm ujin në kaldajë, mbyllni paraprakisht valvulat e ndërprerjes midis impiantit dhe kaldajës, para se të rrotulloni dorezën e rubinetit.




fig. 16- Valvuli i ngarkimit




fig. 17

2. Instalimi

2.1 Dispozita të përgjithshme

INSTALIMI I KALDAJËS DUHET TË KRYHET VETËM NGA PERSON I SPECIALIZUAR DHE ME KUALIFIKIM TË KONTROLLUAR, NË PËRPUTHJE ME GJITHË UDHËZIMET E PËRFSHIRA NË KËTË MANUAL TEKNIK, ME DISPOZITAT LIGJORE NË FUQI, ME NORMATIVAT KOMBËTARE DHE LOKALE SI DHE SIPAS RREGULLAVE TEKNIKE.

2.2 Vendi i instalimit



Qarku i djegësit të pajisjes është hermetik në raport me ambientin e instalimit, kështu që pajisja mund të instalohet në çdo ambient, me përjashtim të garazheve apo vendparkimeve. Megjithatë, ambienti i instalimit duhet të ketë një ajrim të mjaftueshëm për të shmangur krijimin e kushteve të rrezikshme, në rast humbesh gazi, sado të vogla qofshin. Në rast të kundërt, mund të ekzistojë rreziku i asfiksimit dhe helmit apo i shpërthimeve dhe rënies së zjarrit. Kjo normë sigurie është vendosur nga Direktiva CEE n° 2009/142 për gjithë pajisjet me gaz, edhe për ato që punojnë me dhoma hermetike.

Pajisja është projektuar për të punuar në vende pjesërisht të mbrojtura, me temperatura minimale -5°C. Nëse pajisjet me aparatën e posaçëm kundër ngrirjes, mund të përdoret me temperaturë minimale deri në -15°C. Kaldaja duhet të instalohet në një vend të mbrojtur, për shembull nën pjerësinë e një çatie, brenda një ballkoni ose në një qoshe të mbrojtur.

Në çdo rast, në vendin e instalimit nuk duhet të ketë pluhur, objekte apo materiale që marrin flakë ose gaze gërryes.

Kaldaja është projektuar për instalim me varje në mur si dhe është i pajisur, si standard, me një çengel për varjen. Vendosja në mur duhet të garantojë një mbështetje të qëndrueshme dhe efikase të gjeneratorit.



Nëse pajisja vendoset e mbyllur brenda mobilieeve ose e montuar në anë të tyre, duhet parashikuar hapësira e nevojshme për çmontimin e kasës së jashtme dhe kryerjen e proceseve normale të mirëmbajtjes.

2.3 Lidhjet hidraulike

Paralajmërime



Vendshkarkimi i valvulit të sigurisë duhet të lidhet në një hinkë ose tub grumbullues, për të shmangur derdhjen e ujit përtokë në rast mbipresioni në qarkun e ngrohjes. Nëse valvuli i shkarkimit bëhet shkak për përmytjen e dhomës, në këtë rast përgjegjësia nuk bie tek ndërtuesi i kaldajës.



Para instalimit, lani me kujdes gjithë tubacionet e impiantit për të hequr mbetjet ose papastërtitë që mund të komprometojnë funksionimin e mirë të pajisjes.

Në rast se zëvendësohen gjeneratorët në instalimet ekzistuese, impianti duhet të boshatiset plotësisht dhe të pastrohet si duhet nga balta dhe ndotjet. Për këtë, përdorni vetëm produkte të përshtatshme dhe të garantuara për impiantet termike (referojuni paragrafit të mëtejshëm), që nuk dobësojnë metalet, plastikat ose gomën. **Ndërtuesi nuk mban përgjegjësi për dëme të mundshme të shkaktuara në gjenerator nga mospastrimi ose pastrimi jo i duhur i impiantit.**

Kryeni lidhjet në bashkimet përkatëse, duke pasur kujdes simbolet e shënuara mbi pajisje.

Sistemi kundër ngriries, lëngjet antifriz, aditivët dhe inhibitorët

Nëse është e nevojshme, lejohet përdorimi i lëngjeve antifriz, i aditivëve dhe inhibitorëve, vetëm nëse prodhuesi i këtyre lëngjeve apo aditivëve jep garancinë e ju siguron që produktet e tij janë të përshtatshëm për përdorim dhe nuk shkaktojnë dëme tek shkëmbyesi i kaldajës ose në komponentë dhe/ose materiale të tjerë të kaldajës dhe impiantit. Është i ndaluar përdorimi i lëngjeve antifriz, aditivëve dhe inhibitorëve të përgjithshëm, të papërshtatshëm posaçërisht për përdorim në impiante termike dhe të përshtatshëm për materialet e kaldajës dhe të impiantit.

Karakteristikat e ujit të impiantit



Kaldajat **BlueHelix ALPHA C** janë të përshtatshme për t'u instaluar në sistemet e ngrohjes me hyrje oksigjeni jo domethënëse (referojuni sistemeve "çështja I" norma EN14868). Në sistemet me emetime oksigjeni të vazhdueshme (për shembull, impiante dyshemeje pa tuba kundër difuzionit ose me enë të hapur), ose me ndërprerje (më pak se 20% të përbajtjes së ujit të impiantit) duhet të parashikohet një ndarës fizik (për shembull, shkëmbyes me piastra).

Uji në brendësi të një impianti ngrohjeje duhet të jetë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi, me karakteristikat e specifikuar në normën UNI 8065 dhe duhet të ndiqen specifikimet e normës EN14868 (mbrojtja e materialeve metalike kundër korrozionit).

Uji mbushës (mbushja e parë duke shtuar herë pas herë) duhet të jetë i kthjellët, me fortësi nën 15°F dhe i trajtuar me kimikate të miratuara si të përshtatshme, për të garantuar moskrijimin e koreve, veprime gërryese apo agresive mbi metale dhe lëndët plastike, moskrijimin e gazeve dhe në impiantet me temperaturë të ulët të mos përhapen masa bakteresh ose mikrobesh.

Uji që përbëan impianti duhet të kontrollohet periodikisht (të paktën dy herë në vit gjatë sezonit të përdorimit të impianteve, siç parashikohet nga UNI8065) dhe të ketë pamje mundësisht të kthjellët, fortësi nën 15°F për impiantet e reja dhe 20°F për impiantet ekzistuese, PH mbi 7 dhe nën 8,5, përbajtje hekuri (si Fe) nën 0,5 mg/l, përbajtje bakri (si Cu) nën 0,1 mg/l, përbajtje kloruri nën 50mg/l, përcjellshmëri elektrike nën 200 µs/cm dhe duhet të përbëjë kimikatesh në një përqendrim të mjaftueshëm për ta mbrojtur impiantin për të paktën një vit. Në impiantet me temperaturë të ulët nuk duhet të ketë ngarkesa bakteresh ose mikrobesh.

Kondicionuesit, aditivët, inhibitorët dhe lëngjet antifriz duhet të deklarohen nga prodhuesi si të përshtatshëm për përdorimin në impiante ngrohjeje dhe që nuk i shkaktojnë dëme

shkëmbyesit të kaldajës ose komponentëve dhe/ose materialeve të tjera të kaldajës dhe të impiantit.

Kimikatet duhet të garantojnë një deoksigenim të plotë të ujit, duhet të kenë mbrojtës specifikë për metalet e verdha (bakri dhe lidhjet e tij), antingurtësues për çmërsin, stabilizantë me PH neutral dhe në impiantet me temperaturë të ulët, biocide specifike për përdorimin në impiante ngrohjeje.

Kimikatet e këshilluar:

SENTINEL X100 e SENTINEL X200

FERNOX F1 dhe FERNOX F3

Pajisja është e pajisur me një sistem antifriz që aktivizon kaldajën në modalitetin e ngrohjes kur temperatura e prurjes së ujit të impiantit zbret nën 6 °C. Aparati nuk është aktiv nëse hiqet ushqimi elektrik dhe/ose gazi i pajisjes. Nëse nevojitet, për mbrojtjen e impiantit përdorni lëng antifriz të përshtatshëm që përputhet me kriteret e lartpërmendura dhe të parashikuara nga norma UNI 8065.

Me trajtimet e duhura kimike fizike të ujit të impiantit, dhe atij ushqyes, si dhe të kontrolleve përkatëse me ciklicitet të lartë që garantojnë parametrat e kërkuar, vetëm për aplikime procesesh industriale, lejohet instalimi i produktit në impiante me enë të hapur me lartësi hidrostatike të tillë të enës, që të garantojë respektimin e presionit minimal të funksionimit sipas specifikimeve teknike të produktit.

Prania e depozitimeve mbi sipërfaqet e shkëmbyesit të kaldajës si pasojë e mosrespektimit të udhëzimeve të mësipërme, do të zhvlerësojë njohjen e garancisë.

2.4 Lidhja e gazit



Para se të kryeni lidhjen, verifikoni nëse pajisja është konfiguruar për të funksionuar me llojin e lëndës djegëse të disponueshme.

Lidhja e gazit duhet të kryhet në vendin përkatës (shih fig. 35 dhe fig. 39) në përputhje me normativën në fuqi, me tub metalik të ngurtë ose me tub fleksibël me mur të vazhduar me çelik inoks, duke ndërfutur një rubinet gazi midis impiantit dhe kaldajës. Kontrolloni nëse të gjitha lidhjet e gazit janë të mbyllura hermetikisht. Në rast të kundërt, mund të ekzistojë rreziku i rënies së zjarrit, i shpërthimit ose asfiksimit.

2.5 Lidhjet elektrike

PARALAJMËRIME



PARA SE TË KRYENI ÇFARËDO LLOJ VEPRIMI QË KËRKON HEQJEN E KASËS SË JASHTME, SHKËPUTENI KALDAJËN NGA RRJETI ELEKTRIK PËRMES ÇELËSIT KRYESOR.

MOS I PREKNI NË ASNJË MËNYRË KOMPONENTËT ELEKTRIKË OSE KONTAKTET, KUR ÇELËSI KRYE-

SOR VSHTË I NDEZUR! EKZISTON RREZIKU I GODITJES ELEKTRIKE, I CILI MUND TË SHKAKTOJË LËNDIME OSE VDEKJE!

Pajisja duhet të lidhet me një impiant të tokëzuar mirë, siç parashikohet nga normat e sigurisë në fuqi. Kontrolloni nga persona profesionalisht të kualifikuar, efikasitetin dhe përshtatshmërinë e impiantit të tokës, pasi ndërtuesi nuk është përgjegjës për dëme të mundshme të shkaktuara nga mungesa e tokëzimit të impiantit.

Kaldaja është lidhur paraprakisht me kablllo lidhës për linjën elektrike trepolare, pa spinë. Lidhjet në rrjet duhet të kryhen me bashkime fikse dhe të pajisura me një çelës bipolar, kontaktet e të cilit të kenë një hapje prej të paktën 3 mm, duke ndërfutur siguresa 3A maksimumi, midis kaldajës dhe linjës. Është e rëndësishme të respektohet polariteti (FAZA: fija bojëkafe / NULI: fija blu / TOKËZIMI: fija e verdhë-e gjelbër) në lidhjet me linjën elektrike.



Kablli i ushqimit të pajisjes **NUK DUHET TË ZËVENDËSOHET NGA PËRDORUESI**. Në rast dëmtimi të kabllit, fiken i pajisjen dhe për zëvendësimin e kabllit, drejtojuni vetëm personave të kualifikuar profesionalisht. Në rast zëvendësimi, përdorni vetëm kablllo “**HAR H05 VV-F**” 3x0,75 mm² me diametër të jashtëm maksimal 8 mm.

Termostati i ambientit (opsional)

KUJDES: TERMOSTATI I AMBIENTIT DUHET T’I KETË KONTAKTET TË PASTRA. NËSE LIDHNI 230 V. NË MORSETAT E TERMOSTATIT TË AMBIENTIT, SKEDA ELEKTRIKE DËMTOHET NË MËNYRË TË PARIKUPE-RUESHME.

Kur lidhni kronokomanda ose kohëmatës, mos i ushqeni këta aparate nga kontaktet e tyre ndërprerëse. Ato duhet të ushqehen me energji duke u lidhur direkt në rrjet ose me anë të pilave, në varësi të llojit të aparatit.

Hyria në morsetierën elektrike dhe në siguresë

Pasi të jetë hequr paneli i përpamë (sez. "Hapja e panelit të përpamë" a pag. 34) është e mundur të hyni te morsetierat (M) dhe te siguresa (F) duke ndjekur udhëzimet e përshkruara në vijim (fig. 18 dhe fig. 19). **Morsetat që treguara në fig. 18 duhet të kenë kontakte të pastra (jo 230V).** Llojet e ndryshme të morsetave për lidhjet e ndryshme, janë paraqitur edhe në skemën elektrike në fig. 45.




fig. 18




fig. 19

Skeda e rele së ndryshueshme të daljes LC32 (opsionale - 043011X0)

Releja e ndryshueshme e daljes **LC32**, përbëhet nga një skedë e vogël me një shkëmbyes kontaktesh të lira (kur është e mbyllur do të thotë kontakt midis C dhe NA). Funkzioni menaxhohet nga softueri.

Për instalimin ndiqni me kujdes udhëzimet që ndodhen në ambalazhin e paketës dhe mbi skemën elektrike të fig. 45.

Për të përdorur funksionin e dëshiruar, referojuni tabella 2.

Tabella. 2- Cilësimet LC32

Parametri b07	Funksioni LC32	Veprimi LC32
0	Menaxhon një valvul gazit dytësore (të parazgjedhur)	Kontaktet mbyllen kur valvuli i gazit (në kal-dajë) ushqehet
1	Përdorimi si dalje e alarmit (ndeja e llambushkës)	Kontaktet mbyllen kur ka një gjendje gabimi (të përgjithshëm)

Parametri b07	Funksioni LC32	Veprimi LC32
2	Menaxhon një valvul mbushjeje të ujit	Kontaktet mbyllen deri kur presioni i ujit të qarkut të ngrohjes rivendoset në nivel normal (pas një shtimi manual ose automatik)
3	Menaxhon një valvul diellor me 3 dalje	Kontaktet mbyllen kur modaliteti i ujit sanitar është aktiv
4	Menaxhon një pompë të dytë ngrohjeje	Kontaktet mbyllen kur modaliteti i ngrohjes është aktiv
5	Përdorimi si dalje e alarmit (fikja e llambu-shkës)	Kontaktet hapen kur ka një gjendje gabimi (të përgjithshëm)
6	Tregon ndezjen e djegësit	Kontaktet mbyllen kur flaka është e pranishme
7	Menaxhon ngrohësin e sifonit	Kontaktet mbyllen kur modaliteti antifriz është aktiv

Konfigurimi i çelësit ON/OFF (A fig. 19)

Tabella. 3- Cilësimet e çelësit A

Konfigurimi DHW	Parametri b06	
b01 = 3	b06=0	Nëse kontakti është i hapur, çaktivizon ujin shtëpiak, nëse është i mbyllur e riaktivizon.
	b06=1	Nëse kontakti është i hapur, çaktivizon ngrohjen dhe shfaq F50 . Nëse është i mbyllur, aktivizon ngrohjen.
	b06=2	Kontakti funksionon si një termostat ambient.
	b06=3	Nëse kontakti është i hapur, do të shfaqë F51 dhe kaldaja do të vazhdojë të funksionojë. Do të përdoret si alarm.
	b06=4	Kontakti funksionon si termostat limit F53 dhe e fik kërkesën.

2.6 Kanalet e tymrave



KALDAJAT DUHET TË INSTALOHEN NË DHOMA QË JANË NË PËRPUTHJE ME KRITERET THEMELORE TË AJRIMIT. NË RAST TË KUNDËRT, EKZISTON RREZIKU I ASFIKSIMIT OSE I HELMIMIT.

LEXONI UDHËZIMET E INSTALIMIT DHE TË MIRËMBAJTJES PARA SE TË INSTALONI PAJISJEN.

RESPEKTONI EDHE UDHËZIMET E PROJEKTIMIT.

NË RAST SE PRESIONET NË BRENDËSI TË TUBACIONEVE TË SHKARKIMIT TË TYMRAVE JANE MBI 200 Pa, ËSHTË E DETYRUESHME TË PËRDOREN OXHAKË TË KLASIT “H1”.

Paralaimërime

Pajisja është e "tipit C" me dhomë hermetike dhe me thithje të forcurar, hyrja e ajrit dhe dalja e tymrave duhet të lidhen në një nga sistemet e shkarkimit/aspirimit që specifikohen më poshtë. Përpara se të vijoni në instalimin, kontrolloni dhe respektoni me përpikëri këto udhëzime. Respektoni gjithashtu dispozitat përkatëse lidhur me pozicionimin e terminaleve në mur dhe/ose në çati si dhe distancat minimale nga dritaret, muret, vrimat e ajrimit, etj.

Në rastin e instalimit me rezistencë maksimale (oxhak koaksial ose i ndarë), këshillohet të bëni një kalibrim manual të plotë për të optimizuar djegien e kaldajës.

Lidhja me tubat koaksiale




fig. 20- Shembuj të lidhjes me tuba koaksiale (⇨ = Ajër / ⇩ = Tymra)

Për lidhjen koaksiale, montoni në pajisje një nga aksesorët e mëposhtëm të pikënisjes. Për kuotat e shpimit në mur, referojuni figurës në kopertinë. Është e nevojshme që disa pjesë horizontale të tubacioneve të shkarkimit të tymrave të mbahen në pjerrësi të lehtë në drejtim të kaldajës për të parandaluar që një kondensim i mundshëm të rrjedhë jashtë duke shkaktuar bulëza.




fig. 21- Aksesorët e pikënisjes për kanalet koaksiale

Tabella. 4- Gjatësia maksimale e tubave koaksiale

	Koaksiale 60/100	Koaksiale 80/125
Gjatësia maksimale e lejuar (horizontalisht)	Të gjithë modelet 7 m	BlueHelix ALPHA 24 C = 28 m BlueHelix ALPHA 28 C = 20 m BlueHelix ALPHA 34 C = 20 m
Gjatësia maksimale e lejuar (vertikalisht)	Të gjithë modelet 8 m	
Faktori i reduktimit të harkut 90°	1 m	0,5 m
Faktori i reduktimit të harkut 45°	0,5 m	0.25 m

Lidhja me tuba të veçuar




fig. 22- Shembuj të lidhjes me tuba të veçuar (⇨ = Ajër / ⇨ = Tymra)

Tabella. 5- Tipologjia

Tipi	Përshkrimi
C1X	Aspirimi dhe shkarkimi horizontal në mur. Terminalet e hyrjes/daljes duhet të jenë koncentrikë ose mjaftueshëm afër, për t'iu nënshtruar kushteve të ngjashme të erës (brenda 50 cm)
C3X	Aspirimi dhe shkarkimi vertikal në çati. Terminalet e hyrjes/daljes si për C12
C5X	Aspirimi dhe shkarkimi të ndara në mur ose në çati por në çdo rast në zona me presione të ndryshme. Shkarkimi dhe aspirimi nuk duhet të vendosen në mure të kundërta.
C6X	Aspirimi dhe shkarkimi me tuba të certifikuar veçmas (EN 1856/1)
B2X	Aspirimi nga dhoma e instalimit dhe shkarkimi në mur ose në çati ⚠ E RËNDËSISHME - DHOMA DUHET TË KETË NJË AJRIM TË PËRSHTATSHËM

Për lidhjen e kanaleve të veçuar, montoni në pajisje aksesorin e mëposhtëm të pikënisjes:




fig. 23- Aksesor i pikënisjes për kanalet e veçuar

Përpara se të vijoni me instalimin, kontrolloni që të mos tejkalohet gjatësia maksimale e lejuar, përmes një llogarie të thjeshtë:

1. Përcaktوني plotësisht skemën e sistemit të oxhakëve të ndarë në dy pjesë, duke përfshirë aksesorët dhe terminalët e daljes.
2. Referojuni tabella 7 dhe identifikoni humbjet në m_{eq} (metra ekuivalente) të çdo komponenti, sipas pozicionit të instalimit.
3. Kontrolloni nëse shuma totale e humbjeve është më e ulët ose e barabartë me gjatësinë maksimale të lejuar në tabella 6.

Tabella. 6- Gjatësia maksimale e tubave të veçuar

Gjatësia maksimale e lejuar	BlueHelix ALPHA 24 C = 80 m_{eq} BlueHelix ALPHA 28 C = 70 m_{eq} BlueHelix ALPHA 34 C = 70 m_{eq}
-----------------------------	---

Tabella. 7- Aksesorët

				Humbjet në m _{eq}		
				Aspirimi ajri	Shkarkimi i tymrave	
					Vertikal	Horizontal
Ø 80	TUB	1 m M/F	1KWMA83W	1,0	1,6	2,0
	HARK	45° M/F	1KWMA65W	1,2	1,8	
		90° M/F	1KWMA01W	1,5	2,0	
	TRONKETË	me kapëse test	1KWMA70W	0,3	0,3	
	TERMINAL	ajri në mur	1KWMA85A	2,0	-	
		tymra në mur me mbrojtje nga era	1KWMA86A	-	5,0	
	OXHAK	Ajër/tymra i veçuar 80/80	010027X0	-	12,0	
		Vetëm dalje e tymrave Ø80	010026X0 + 1KWMA86U	-	4,0	
Ø 60	TUB	1 m M/F	1KWMA89W		6.0	
	HARK	90° M/F	1KWMA88W		4.5	
	REDUKTOR	80/60	041050X0		5.0	
	TERMINAL	tymra në mur me mbrojtje nga era	1KWMA90A		7.0	
Ø 50	TUB	1 m M/F	041086X0		12	
	HARK	90° M/F	041085X0		9	
	REDUKTOR	80/50	041087X0		10	
		KUJDES: MERRNI PARASYSH HUMBJET E MËDHA TË NGARKIMIT TË AKSE-SORËVE Ø50 dhe Ø60, PËRDORINI ATO VETËM NËSE ËSHTË E NEVOJSHME DHE NË PËRPUTHJE ME PJESËN E FUNDIT TË SHKARKIMIT TË TYMRAVE.				

Përdorim i tubave fleksibël dhe të ngurtë Ø50 dhe Ø60

Në përlogaritjen e paraqitur në tabelat e mëposhtme përfshihen aksesorët e pikënisjes me kodin 041087X0 për Ø50 dhe kodin 041050X0 për Ø60.

Tub fleksibël

Mund të përdoren maksimumi 4 metra oxhak Ø80 mm midis kaldajës dhe pasazhit me diametër të reduktuar (Ø50 ose Ø60), dhe maksimumi 4 metra oxhak Ø80 mm në aspirim (me gjatësi maksimale të oxhakëve Ø50 dhe Ø60) Shihni .




fig. 24- Skema për intubim të vetëm me tub fleksibël

BlueHelix ALPHA 24 C

Ø50 - 28 m MAX

Ø60 - 78 m MAX

BlueHelix ALPHA 28 C

Ø50 - 22 m MAX

Ø60 - 60 m MAX

BlueHelix ALPHA 34 C

Ø50 - 17 m MAX

Ø60 - 45 m MAX

Tua fleksibël dhe tuba të ngurtë

Për përdorimin e këtyre diametrave, ndiqni udhëzimet e mëposhtme.

Hyni në menunë **TS** dhe vendosni vlerën e parametrin **P68** në vlerën që korrespondon me gjatësinë e oxhakut të përdorur. Pasi të keni modifikuar vlerën, vijoni me **kalibrimin e plotë manual** (shihni sez. "Kalibrimi i plotë manual" a pag. 27).

— · — · — · Për mod. **BlueHelix ALPHA 24 C**

— — — — — Për mod. **BlueHelix ALPHA 28 C**

————— Për mod. **BlueHelix ALPHA 34 C**




fig. 25- Grafiku për zgjedhjen e parametrin të oxhakut

Lidhja me oxhakë kolektive tymrash




fig. 26- Shembuj të lidhjes me oxhakë tymrash (⇨ = Ajër / ⇨ = Tymra)

Tabella. 8- Tipologjia

Tipi	Përshkrimi
C8X	Shkarkimi në një oxhak të vetëm ose të përbashkët të tymrave me aspirim në mur
B3X	Aspirimi nga dhoma e instalimit përmes kanalit koncentrik (që përfshin shkarkimin) dhe shkarkimi në oxhak të përbashkët të tymrave me thithje natyrale ⚠ E RËNDËSISHME - DHOMA DUHET TË KETË NJË AJRIM TË PËRSHTATSHËM
C93	Shkarkimi në një terminal vertikal dhe aspirimi nga oxhaku ekzistues i tymrave.

Nëse keni ndërmend ta lidhni kaldajën **BlueHelix ALPHA C** në një oxhak tymrash apo në një oxhak të vetëm me thithje natyrale, këto duhet të jenë projektuar posaçërisht nga teknikë të kualifikuar profesionalisht, në përputhje me normat në fuqi si dhe të jenë të përshtatshme për pajisjet me dhomë hermetike të pajisura me ventilator.

Valvuli kundër përmytjes me kllapë

Kaldaja **BlueHelix ALPHA C** mund të lidhet me oxhakët e përbashkët të tymrave me presion pozitiv **vetëm nëse funksionon me gaz G20** dhe nëse është pajisur me **KOMPLET VALVULASH ME KLLAPË** (ref. A - fig. 27) me kod **041106X0**. Paketa duhet të instalohet sipas udhëzimeve të fig. 27.

Pas instalimit të kompletit, është e nevojshme të vendoset parametri **P67** me **1** dhe të vijohet me **kalibrimin e plotë manual** (shihni “Kalibrimi i plotë manual” on page 27).

Në rastin e instalimit të kaldajës së tipit C10, vendosni mbi **PANELIN E PËRPARMË, NË MËNYRË TË DUKSHME**, etiketën ngjitëse të bardhë që mund ta gjeni brenda zarfit të dokumenteve që merret bashkë me pajisjen.

Kur të përfundojë instalimi, verifikoni mbylljet e qarkut të gazit dhe të tymrave.

NË RAST TË KUNDËRT, EKZISTON RREZIKU I ASFIKSIMIT, SI PASOJË E DALJES SË TYMRAVE NGA DJEGIA.




fig. 27- Komplet i VALVULAVE ME KLLAPË

2.7 Lidhja e tubit të shkarkimit të kondensimit

PARALAJMËRIME

Kaldaja është e pajisur me sifon të brendshëm për shkarkimin e kondensimit. Instaloni tubin fleksibël "B" duke e kaluar me presion. Para vënies në punë, mbusheni sifonin me rreth 0,5 lt. Ujë dhe lidhni tubin fleksibël me impiantin e trajtimit të mbeturinave.

Tubat shkarkues që lidhen me rrjetin e kanalizimeve duhet të jenë rezistentë me kondensimet acide.

Nëse tubi shkarkues i kondensimit nuk lidhet me sistemin e shkarkimit të ujërave të zeza, është i nevojshëm instalimi i një neutralizuesi.



KUJDES: PAJISJA NUK DUHET TË VIHET ASNJËHËRË NË FUNKSION ME SIFON TË BOSHATISUR!

NË RAST TË KUNDËRT, EKZISTON RREZIKU I ASFIK-SIMIT, SI PASOJË E DALJES SË TYMRAVE NGA DJEGIA.

ËSHTË E NEVOJSHME TË KRYHET LIDHJA E TUBIT SHKARKUES TË KONDENSIMIT ME IMPIANTIN E RRJETIT TË KANALIZIMEVE, NË MËNYRË TË TILLË QË LËNGU TË MOS NGRIJË.




fig. 28- Lidhja e tubit të shkarkimit të ujit të kondensuar

3. Shërbimi dhe mirëmbajtja



Të gjitha rregulloret që përshkruhen në këtë kapitull mund të kryhen vetëm nga persona të kualifikuar.

3.1 Rregulloret

Konvertimi i gazit ushqyes

Pajisja mund të funksionojë me ushqim me gaz të **II^{për} familje** ose të **III^{për}** dhe specifikohet qartë në ambalazh dhe në etiketën e të dhënave teknike të vetë pajisjes. Nëse është e nevojshme ta përdorni pajisjen me një gaz të ndryshëm nga ai i konfiguruar paraprakisht, është e nevojshme të veproni si më poshtë:

1. Shkëputni ushqimin elektrik dhe mbyllni gazin.
2. Hiqni panelin e përparmë (**shihni sez. "Hapja e panelit të përparmë" a pag. 34**).
3. Vendosni etiketën që lidhet me gazin GPL, të cilën e gjeni në zarfin e dokumenteve, pranë etiketës së të dhënave teknike.
4. Rimontoni panelin e përparmë dhe ushqeni kaldajën me energji elektrike.
5. **Modifikoni parametrin e posaçëm për llojin e gazit:**

- Kalojeni kaldajën në modalitet stand-by dhe shtypni butonin **Reset** (pjesa 6 - fig. 1) për 10 sekonda.
- Në ekran shfaqet **100** dhe teksti "**co**" pulson; shtypni butonin "**Ngrohje +**" (pjesa 4 - fig. 1) derisa të konfiguroni dhe të shfaqet **120**.
Më pas, shtypni butonin "**Ujë shtëpiak +**" (pjesa 2 - fig. 1) derisa të konfiguroni **123**.
- Shtypni 1 herë butonin **Reset** (pjesa 6 - fig. 1).
- Në ekran shfaqet **tS** duke pulsuar;
- Shtypni 1 herë butonin **Reset** (pjesa 6 - fig. 1).
- Përmes butonit "**Ngrohje +**" (pjesa 4 - fig. 1) lëvizeni deri në parametrin **b03**.
- Përmes butonit "**Ujë shtëpiak +**" (pjesa 4 - fig. 1) konfiguroni:

0 =G20 - Gaz natyror (konfigurimi standard)

1 =G30/G31 Gaz i lëngët

2 =G230 Ajër i propanuar

- Shtypni butonin "**Ngrohje +**" (pjesa 4 - fig. 1) për të konfirmuar (Duke ndryshuar vlerën e parametrit **b03**, ndryshon automatikisht vlera e parametrit **b27** në **5**).
- Shtypni butonin **Reset** (pjesa 6 - fig. 1) për 10 sekonda.
- Shkëputni ushqimin elektrik për 10 sekonda e më pas rivendoseni.
- Prisni derisa të ketë përfunduar modaliteti **Fh**.
- Kalojeni kaldajën në modalitetin stand-by dhe aktivizoni modalitetin e kalibrimit të plotë manual duke shtypur njëkohësisht **butonat "OFF/verë/dimër"** dhe "**Ngrohje +**" për 5 sekonda. Në ekran do të shfaqen duke pulsuar simbolet "**Au**" dhe "**to**". Pas ndezjes së djegësit (simbolet që pulsojnë "Hi+flaka+rubineti+radiator"), kaldaja do të bëjë kalibrimin në tre nivelet e fuqisë "**Hi**", "**ME**" dhe "**Lo**". Në fund do të shfaqet një vlerë numerike (në këtë moment, kaldaja është me fuqi minimale "**Lo**").
- Nëse vlerat e **CO₂** nuk do të ishin brenda gamës tabella 9, vendosni si vijon: përmes butonave "**Ujë shtëpiak + e -**". Rregulloni **CO₂** me fuqi minimale (Lo), për çdo shtypje të butonave "**Ujë shtëpiak + ose -**", në ekran do të shfaqet vlera e modifikuar dhe më pas ikona "Lo" (për të treguar nivelin e fuqisë minimale).
- Me rritjen e vlerës, do të ulët niveli i **CO₂** dhe anasjelltas.
- Shtypni butonin "**Ngrohje +**" për të kaluar në fuqinë mesatare/ndezjen e "**ME**", në ekran do të shfaqet ikona "**ME**", kur të ketë arritur fuqinë e ndërmjetme/ndezjen, do të shfaqet një vlerë numerike.
- Përmes butonave "**Ujë shtëpiak + dhe -**" rregulloni **CO₂**. Për çdo shtypje të butonave "**Ujë shtëpiak + ose -**", në ekran do të shfaqet vlera e modifikuar dhe më pas ikona "**ME**" (për të treguar nivelin e fuqisë së ndërmjetme/ndezjes).
- Shtypni butonin "**Ngrohje +**" për të kaluar në fuqinë maksimale "**Hi**", në ekran do të shfaqet ikona "**Hi**", kur të ketë arritur fuqinë maksimale, do të shfaqet një vlerë numerike.

- Përmes butonave “**Ujë shtëpiak + dhe -**” rregulloni **CO₂** me fuqi minimale (**Hi**), për çdo shtypje të butonave “**Ujë shtëpiak + ose -**”, në ekran do të shfaqet vlera e modifikuar dhe më pas ikona “**Hi**” (për të treguar nivelin e fuqisë minimale). Në përfundim të rregullimit të **CO₂** me fuqi maksimale, do të jetë gjithsesi e mundur të lëvizni midis tre niveleve të fuqisë “**Hi**” “**ME**” dhe “**Lo**” duke shtypur butonat “**Ngrohje + ose -**” për të riverifikuar ose korrigjuar vlerën e **CO₂**.
- Shtypni butonat “**OFF/verë/dimër**” dhe “**Ngrohje +**” për 5 sekonda për të dalë nga modaliteti i kalibrimit të plotë manual dhe për të ruajtur konfigurimet. Modifikimi i parametrave për të rregulluar **CO₂** në modalitetin e kalibrimit të plotë manual, do të ketë një kohëzgjatje maksimale rreth 8 minuta

Verifikimi i vlerave të djegies

SIGUROHUNI QË PANELI I PËRPARMË TË MBYLLET DHE QË TUBAT E ASPIRIMIT/SHKARKIMIT TË TYMRAVE TË MONTUAR PLOTËSISHT.

1. Kalojeni kaldajën në modalitetin e ngrohjes ose në atë sanitar për të paktën 2 minuta.
2. Aktivizoni modalitetin **TEST** (shih sez. “Aktivizimi i modalitetit TEST” a pag. 28).
3. Me anën e një analizuesi të djegies, të lidhur me rregullimet që ndodhen në aksesorët e pikënisjes mbi kaldajë, verifikoni që përmbajtja e **CO₂** tek tymrat, me kaldajën që funksionon me fuqi maksimale dhe minimale, të korrespondojë me sa specifikohet në tabella 9.

Tabella. 9- Vlerat e CO₂ që duhen respektuar

G20	G30/G31	G230
9% ±0,8	10% ±1	10% ±1

4. Nëse vlerat e djegies nuk korrespondojnë, kryeni **Kalibrimin manual** siç përshkruhet në paragrafin vijues.
5. Aktivizoni kalibrimin manual dhe në fund modifikoni vlerat e **Hi**, **ME** dhe **Lo** për të rivendosur vlerat e **CO₂** si nga tabella 9.

Kalibrimi

E RËNDËSISHME: GJATË PROCEDURËS SË TARIMIT MANUAL TË PLOTË OSE MANUAL OSE GJATË VERIFIKIMIT TË VLERËS SË CO₂, ËSHTË E NEVOJSHME QË PANELI I PËRPARMË TË JETË I MBYLLUR DHE TUBAT E ASPIRIMIT/SHKARKIMIT TË TYMRAVE TË JENË TË MONTUAR PLOTËSISHT.

Kalibrimi manual

Procedura për kryerjen e kalibrimit.

- Vendoseni kaldajën në modalitet **stand-by**.
- Për të aktivizuar kalibrimin manual, shtypni njëkohësisht butonat **OFF/verë/dimër** (pjesa 7 - fig. 1) dhe butonin “**Ngrohje +**” (pjesa 4 - fig. 1) për 5 sekonda. Kalibrimi do të ndizet me kërkesën për ngrohje. Nëse nuk ka shpërndarjen e mjaftueshme të nxehtësisë, mund të kryhet një kërkesë për ujë shtëpiak (valvula me tre drejtime do të ndërrohet automatikisht në qarkun DHW).
- Do të kryhet kalibrimi manual. Në fazën e ndezjes do të shfaqen simbolet që pulsojnë **MA** në alternim me “**nu**”+ **radiatori + rubineti**. Nëse ka flakë të pranishme (ikona që pulsojnë “**Hi** + flaka + rubineti + radiator”), kaldaja do të kryejë kontrollin fillimisht në **Hi** (fuqi maksimale) më pas **ME** (fuqi e ndërmjetme) më pas **Lo** (fuqi minimale). Në çdo moment mund të ndërpritet kalibrimi duke shtypur butonat “**OFF/verë/dimër**” dhe “**Ngrohje +**” për 5 sekonda.
- Në fund, në ekran do të shfaqet një vlerë numerike midis 0 dhe 6 (**në këtë moment, kaldaja është me fuqi minimale “Lo”**). Në këtë pikë mund të rregullohet **CO₂**. Përmes butonave “Ujë shtëpiak + dhe -” rregulloni **CO₂** me fuqi minimale (**Lo**), për çdo shtypje të butonave “**Ujë shtëpiak + ose -**”, në ekran do të shfaqet vlera e modifikuar dhe më pas ikona “**Lo**” (për të treguar nivelin e fuqisë minimale). Gama e rregullimit është midis 0 dhe 6 (në të gjithë nivelet e fuqisë **Hi**, **ME**, **Lo**), me rritjen e vlerës do të rritet niveli i **CO₂** dhe anasjelltas. Shtypni butonin “**Ngrohje +**”, në ekran do të shfaqet ikona “**ME**”, kur të ketë arritur fuqinë e ndërmjetme/ndezjen, do të shfaqet një vlerë numerike. Përmes butonave “**Ujë shtëpiak + dhe -**” rregulloni **CO₂** me fuqi të ndërmjetme/ndezje **ME**, për çdo shtypje të butonave “**Ujë shtëpiak**

+ ose -", në ekran do të shfaqet vlera e modifikuar dhe më pas ikona **"ME"** (për të treguar nivelin e fuqisë minimale). Shtypni butonin "Ngrohje +", në ekran do të shfaqet ikona **"Hi"**, kur të ketë arritur fuqinë maksimale, do të shfaqet një vlerë numerike.

Përmes butonave **"Ujë shtëpiak + dhe -"** rregulloni **CO₂** me fuqi maksimale (**Hi**).

Për çdo shtypje të butonave **"Ujë shtëpiak + ose -"**, në ekran do të shfaqet vlera e modifikuar dhe më pas ikona **"Hi"** (për të treguar nivelin e fuqisë maksimale). Në përfundim të rregullimit të **CO₂** me fuqi maksimale, do të jetë gjithsesi e mundur të lëvizni midis tre niveleve të fuqisë **"Hi"** **"ME"** dhe **"Lo"** duke shtypur butonat **"Ngrohje + ose -"** për të rivefikuar ose korrigjuar vlerën e **CO₂**. Për të dalë dhe për të ruajtur konfigurimet, shtypni njëkohësisht butonat **OFF/verë/dimër** (pjesa 7 - fig. 1) dhe butonin **"Ngrohje +"** (pjesa 4 - fig. 1) për 5 sekonda.

- Modaliteti i kalibrimit do të çaktivizohet gjithsesi pas rreth 5 minutash, nëse nuk shtypen butonat.

Kalibrimi i plotë manual

Kalibrimin e plotë manual mund ta kryhet vetëm nëse parametri **b27** vendoset në **5** dhe duhet të aktivizohet manualisht duke shtypur njëkohësisht butonat **OFF/verë/dimër** (pjesa 7 - fig. 1) dhe butonin **"Ngrohje +"** (pjesa 4 - fig. 1) për 5 sekonda, në kushtet e stand-by.

Është e mundur të vendoset manualisht parametri **b27** në vlerën **5** ose në modalitetet e mëposhtme:

- duke modifikuar parametrin **"Iloji i gazit" b03** (parametri **b27** vendoset automatikisht në **5**)
- duke konfiguruar parametrin **P67** në **1** (parametri **b27** vendoset automatikisht në **5**)
- duke modifikuar vlerën **P68** (parametri **b27** vendoset automatikisht në **5**)
- duke zgjedhur **"Rivendosja e vlerave të fabrikës"** me parametrin **b29** (parametri **b27** vendoset automatikisht në **5**)

Është e nevojshme të kryhet **kalibrimi i plotë manual** në rastet e mëposhtëm:

- pas zëvendësimit të skedës elektrike
- pas kryerjes së ndërrimit të gazit (**b03**)
- duke konfiguruar parametrin **P67** në **1**
- pas modifikimit të vlerës së parametrin **P68**
- pas konfigurimit të parametrin **b27** në **5** për zëvendësimin e komponentëve të tillë si elektroda, djegësi, valvulli i gazit, ventilatori ose për instalime me rezistencë maksimale, oxhakët
- kur verifikohen kushte anomalie në **A01**, **A06** ose në **anomalitë tjera, ku kërkohet** (shihni tabella 11. Respekttoni hapat e zgjidhjeve të anomaliave).

Kalibrimi i plotë manual rivendos parametrat e djegies të regjistruara paraprakisht dhe duhet të kryhet vetëm në rastet e përshkruara më sipër.

Procedura:

- Kalojeni kaldajën në modalitetin stand-by dhe aktivizoni modalitetin e kalibrimit të plotë manual duke shtypur njëkohësisht butonat **"OFF/verë/dimër"** dhe **"Ngrohje +"** për 5 sekonda. Në ekran do të shfaqen duke pulsuar simbolet **"Au"** dhe **"to"**. Pas ndezjes së djegësit (ikonat që pulsojnë **"Hi+flaka+rubineti+radiator"**), kaldaja do të bëjë kalibrimin në tre nivelet e fuqisë **"Hi"**, **"ME"** dhe **"Lo"**. Në fund do të shfaqet një vlerë numerike (në këtë moment, kaldaja është me fuqi minimale **"Lo"**).
- Nëse vlerat e **CO₂** nuk do të ishin brenda gamës tabella 9, vijoni si më poshtë: përmes butonave **"Ujë shtëpiak + e -"** rregulloni **CO₂** me fuqi minimale (**Lo**). Për çdo shtypje të butonave **"Ujë shtëpiak + ose -"**, në ekran do të shfaqet vlera e modifikuar dhe më pas ikona **"Lo"** (për të treguar nivelin e fuqisë minimale).
- Me rritjen e vlerës, do të ulet niveli i **CO₂** dhe anasjelltas.
- Shtypni butonin **"Ngrohje +"** për të kaluar në fuqinë mesatare/ndezjen e **"ME"**, në ekran do të shfaqet ikona **"ME"**, kur të ketë arritur fuqinë e ndërmjetme/ndezjen, do të shfaqet një vlerë numerike. Përmes butonave **"Ujë shtëpiak + dhe -"** rregulloni **CO₂**. Për çdo shtypje të butonave **"Ujë shtëpiak + ose -"**, në ekran do të shfaqet vlera e modifikuar dhe më pas ikona **"ME"** (për të treguar nivelin e fuqisë së ndërmjetme/ndezjes). Shtypni butonin **"Ngrohje +"** për të kaluar në fuqinë maksimale **"Hi"**. Në ekran do të shfaqet ikona **"Hi"** dhe kur të ketë arritur fuqinë maksimale, do të shfaqet një vlerë numerike.

- Përmes butonave “**Ujë shtëpiak + dhe -**” rregulloni CO₂ me fuqi minimale (Hi), për çdo shtypje të butonave “**Ujë shtëpiak + ose -**”, në ekran do të shfaqet vlera e modifikuar dhe më pas ikona “**Hi**” (për të treguar nivelin e fuqisë minimale). Në përfundim të rregullimit të CO₂ me fuqi maksimale, do të jetë gjithsesi e mundur të lëvizni midis tre niveleve të fuqisë “**Hi**” “**ME**” dhe “**Lo**” duke shtypur butonat “**Ngrohje + ose -**” për të verifikuar ose korrigjuar vlerën e CO₂.
- Shtypni butonat “**OFF/verë/dimër**” dhe “**Ngrohje +**” për 5 sekonda për të dalë nga modaliteti i kalibrimit të plotë manual dhe për të ruajtur konfigurimet. Modifikimi i parametrave për të rregulluar CO₂ në modalitetin e kalibrimit të plotë manual, do të ketë një kohëzgjatje maksimale rreth 8 minuta.

Aktivizimi i modalitetit TEST

Bëni një kërkesë për ngrohje ose ujë shtëpiak.

Shtypni njëkohësisht butonat e ngrohjes (pjesa 3 dhe 4 - fig. 1) për 5 sekonda, për të aktivizuar modalitetin **TEST**. Pas fikjes, kaldaja rregullohet në ngrohjen me fuqi maksimale (parametri **P41** përcakton fuqinë maksimale të ngrohjes dhe ndryshon në bazë të modelit të zgjedhur të kaldajës). Në ekran, simbolet e ngrohjes dhe të ujit shtëpiak (fig. 29) pulsojnë dhe do të shfaqet fuqia e ngrohjes.




fig. 29- Modaliteti TEST (fuqia e ngrohjes = 100%)

Shtypni butonat e ngrohjes (pjesa 3 dhe 4 - fig. 1) për rritjen ose zvogëlimin e fuqisë (minimale=0%, maksimale=100%).

Duke shtypur butonat e ujit shtëpiak “-” (pjesa 1 - fig. 1) fuqia e kaldajës rregullohet menjëherë në vlerë minimale (0%).

Prisni rreth 1 minutë që të stabilizohet.

Duke shtypur butonin e ujit shtëpiak “+” (pjesa 2 - fig. 1) fuqia e kaldajës rregullohet menjëherë në vlerë maksimale (100%).

Në rast se aktivizohet modaliteti TEST dhe hapet uji i ngrohtë shtëpiak, të mjaftueshëm për aktivizimin e modalitetit të ujit shtëpiak, kaldaja qëndron në modalitetin TEST por valvuli me 3-dalje pozicionohet në drejtimin e ujit shtëpiak.

Për të çaktivizuar modalitetin TEST, shtypni njëkohësisht butonat e ngrohjes (pjesa 3 dhe 4 - fig. 1) për 5 sekonda.

Në çdo rast, modaliteti TEST çaktivizohet automatikisht pas 15 minutash ose duke mbyllur ujin e ngrohtë shtëpiak (në rast se nga hapja ka dalë mjaftueshëm ujë i ngrohtë shtëpiak për të aktivizuar modalitetin e ujit shtëpiak).

Rregullimi i fuqisë së ngrohjes në modalitetin TEST

Për të rregulluar fuqinë në ngrohje (krahas modifikimit të parametrit **P41**) vendoseni kaldajën në funksionin TEST. Shtypni butonin **"ngrohje + o -"** për të rritur ose zvogëluar fuqinë. Duke shtypur butonin **reset** për 1 sekondë brenda 20 sekondash nga modifikimi, fuqia maksimale do të qëndrojë ajo që sapo është konfiguruar (gama e konfigurueshme **0 ÷ 95**). Dilni nga funksioni **TEST**.

Menuja e shërbimit

HYRJA NË MENUNË E SHËRBIMIT DHE MODIFIKIMI I PARAMETRAVE MUND TË KRYHET VETËM NGA PERSONEL I KUALIFIKUAR.

Hyryrja në menunë e shërbimit të skedës bëhet duke shtypur butonin e risistemimit Reset për 10 sekonda.

Në ekran do të shfaqet: "100" dhe teksti "co" duke pulsuar.

Më pas, me butonat "Ujë shtëpiak" duhet të konfiguroni "103", me butonat e ngrohjes duhet të konfiguroni "123" dhe të konfirmoni duke shtypur butonin Reset.

Janë në dispozicion 4 menu: duke shtypur butonat e ngrohjes do të mund të zgjidhni përkatësisht me rend rritës apo zbritës, **"tS"**, **"In"**, **"Hi"** ose **"rE"**.

Për të hyrë në menunë e zgjedhur, shtypni një herë butonin **reset**.

"tS" - Menuja e parametrevë transparente

Duke shtypur butonat e ngrohjes mund të lëvizni nëpër listën e parametrevë, përkatësisht në rend rritës ose zbritës. Për të shfaqur ose modifikuar vlerën e një parametri mjafton të shtypni butonat "Ujë shtëpiak": modifikimi do të ruhet duke shtypur butonat "ngrohje + o -" (pas modifikimit të vlerës së parametrit, mjafton të kaloni në parametrin vijues ose të mëparshëm për të ruajtur modifikimin).

Tabela. 10- Tabela e parametrevë transparentë

Treguesi	Përshkrimi	Diapazoni	Standard
b01	Zgjedhja e tipit të kaldajës	3 = MONOTERMIKE E KOMBINUAR (E PAMODIFIKUESHME)	3
b02	Lloji i kaldajës	2 = BlueHelix ALPHA 24 C 3 = BlueHelix ALPHA 28 C 4 = BlueHelix ALPHA 34 C	2 = BlueHelix ALPHA 24 C 3 = BlueHelix ALPHA 28 C 4 = BlueHelix ALPHA 34 C
b03	Lloji i gazit	0 = Metan 1 = Gaz i lëngët 2 = Ajër i propanuar	0
b04	Zgjedhja e mbrojtjes së presionit të implantit të ujit	0 = Presostati 1 = Shndërruesi i presionit	0
b05	Funksioni verë/dimër	0 = DIMËR - VERË - OFF 1 = DIMËR - OFF	0 = I aktivizuar
b06	Zgjedhja e funksionimit të kontaktit të ndryshueshëm të hyrjes	0 = Përrjashtimi i flusometrit 1 = Termostati i implantit 2 = Term. i dytë Ambienti 3 = Paralajmërim/Njoftim 4 = Termostati i sigurisë	2
b07	Zgjedhja e funksionimit të skedës së relesë LC32	0 = Valvuli i jashtëm i gazit 1 = Alarmi 2 = Elektrovalvuli i ngarkimit të implantit 3 = Valvuli diellor me 3 dalje 4 = Pompa e dytë e ngrohjes 5 = Alarmi2 6 = Djegësi i ndezur 7 = Antifrizi aktiv	0

Treguesi	Përshkrimi	Diapazoni	Standard
b08	Orët pa hapjen e ujit të ngrohtë shtëpiak	0-24 orë (koha për çaktivizimin e përkohshëm të modalitetit "comfort" pa hapje uji)	24
b09	Zgjedhja e statusit të anomalisë 20	0 = I çaktivizuar 1 = I aktivizuar (Vetëm për versionet me shndërrues presioni)	0
b10	I paimplementuar	--	--
b11	Minutazhi i flusometrit	0 = I çaktivizuar 1-10 = sekonda	0
b12	I paimplementuar	--	--
b13	I paimplementuar	--	--
b14	I paimplementuar	--	--
b15	Zgjedhja e llojit të flusometrit	1 = Flusometri (450 imp/l) 2 = Flusometri (700 imp/l) 3 = Flusometri (190 imp/l)	3
b16	I paimplementuar	--	--
b17	I paimplementuar	--	--
b18	Prurja, aktivizimi i modalitetit të ujit shtëpiak	0-100Lt/min/10	25
b19	Prurja, çaktivizimi i modalitetit të ujit shtëpiak	0-100Lt/min/10	20
b20	Zgjedhja e materialit të oxhakut	0 = Standard 1 = PVC 2 = CPVC	0
b21	I paimplementuar	--	--
b22	I paimplementuar	--	--
b23	Temperatura maksimale e fikjes së oxhakut standard	60-110°C	105
b24	Temperatura maksimale e fikjes së oxhakut PVC	60-110°C	93
b25	Temperatura maksimale e fikjes së oxhakut CPVC	60-110°C	98
b26	I paimplementuar	--	--
b27	Lloji i kalibrimit	0 = Manual 5 = Plotësisht manual	0
b28	I paimplementuar	--	--
b29	Rivendosja e vlerave të fabrikës	Ndryshojeni vlerën nga 0 në 10 duke shtypur butonin "ujë shtëpiak +". Konfirmoni duke shtypur butonin "ngrohje +". (Duke rivendosur vlerat e fabrikës, parametri b27 do të konfigurohet automatikisht në 5 dhe parametri b02 në 2.) Për këtë arsye, është e nevojshme ta konfiguroni parametrin b02 në vlerën e saktë sipas modelit të kaldajës.	0
P30	Platforma e ngrohjes	10÷80 (p.sh. 10=20°C/min, 20=12°C/min, 40=6°C/min, 80=3°C/min)	40
P31	Koha e pritjes për ngrohjen	0-10 minuta	4
P32	Pas-qarkullimi i ngrohjes	0-255 minuta	15
P33	Funksionimi i pompës	0 = Pompë e vazhduar (aktive vetëm në modalitet dimri) 1 = Pompë modulare	1
P34	Modulimi DeltaT i pompës	0 + 40°C	20
P35	Shpejtësia minimale e pompës modulare	30 ÷ 100%	30
P36	Shpejtësia në nisje e pompës modulare	90 ÷ 100%	90

Treguesi	Përshkrimi	Diapazoni	Standard
P37	Shpejtësia maksimale e pompës modulare	90 ÷ 100%	100
P38	Temperatura e fikjes së pompës gjatë fazës së pas-qarkullimit	0 ÷ 100°C	55
P39	Temperatura e histerezës së ndezjes së pompës gjatë fazës së pas-qarkullimit	0 ÷ 100°C	25
P40	Pika maksimale e ngrohjes për përdoruesin	20 ÷ 90°C	80
P41	Fuqinë maksimale e ngrohjes	0 ÷ 95%	BlueHelix ALPHA 24 C = 80 BlueHelix ALPHA 28 C = 85 BlueHelix ALPHA 34 C = 90
P42	Fikja e djegësit në ujin shtëpiak	0 = Fikse 1 = Lidhur me pikën e referencës 2 = Diellore	0
P43	Temperatura e aktivizimit të modalitetit "Comfort"	0 ÷ 80°C	40
P44	Histereza e çaktivizimit të modalitetit "Comfort"	0 ÷ 20°C	20
P45	Koha e pritjes së ujit shtëpiak	30 ÷ 255 sekonda	120
P46	Pika maksimale e referencës për përdoruesin e ujit shtëpiak	40 ÷ 65°C	55
P47	Faza e pas-qarkullimit në pompën e ujit shtëpiak	0 ÷ 255 sekonda	30
P48	Fuqia maksimale e ujit shtëpiak	0 ÷ 100%	100
P49	E paimplementuar (b01=2)	--	--
P50	E paimplementuar (b01=2)	--	--
P51	Temperatura e fikjes së solarit	0 ÷ 100°C	10
P52	Temperatura e ndezjes së solarit	0 ÷ 100°C	10
P53	Koha e pritjes së solarit	0 ÷ 255 sekonda	10
P54	Koha e paraqarkullimit të impiantit	0 ÷ 60 sekonda	30
P55	Modaliteti i mbushjes së impiantit	0 = I çaktivizuar 1 = Automatik	0
P56	Vlera minimale limit e presionit të impiantit	0-8 bar/10 (Vetëm për kaldajat me sensor të presionit të ujit)	4
P57	Vlera nominale e presionit të impiantit	5-20 bar/10 (Vetëm për kaldajat me sensor të presionit të ujit)	7
P58	Vlera maksimale limit e presionit të impiantit	25-35 bar/10 (Vetëm për kaldajat me sensor të presionit të ujit)	28
P59	I paimplementuar	--	--
P60	Fuqia e antifrizit	0 ÷ 50% (0 = minimale)	0
P61	Fuqia minimale	0 ÷ 50% (0 = minimale)	0
P62	Shpejtësia minimale e ventilatorit	MOS E MODIFIKONI (Parametrat përditësohen automatikisht)	G20/G230: - BlueHelix ALPHA 24 C = 76 - BlueHelix ALPHA 28 C = 85 - BlueHelix ALPHA 34 C = 70 G30/G31: - BlueHelix ALPHA 24 C = 73 - BlueHelix ALPHA 28 C = 83 - BlueHelix ALPHA 34 C = 68

Treguesi	Përshkrimi	Diapazoni	Standard
P63	Shpejtësia e ventilatorit në ndezje	MOS E MODIFIKONI (Parametrat përditësohen automatikisht)	G20/G230: - BlueHelix ALPHA 24 C = 200 - BlueHelix ALPHA 28 C = 200 - BlueHelix ALPHA 34 C = 200 G30/G31: - BlueHelix ALPHA 24 C = 186 - BlueHelix ALPHA 28 C = 192 - BlueHelix ALPHA 34 C = 192
P64	Shpejtësia maksimale e ventilatorit	MOS E MODIFIKONI (Parametrat përditësohen automatikisht)	G20/G230: - BlueHelix ALPHA 24 C = 204 - BlueHelix ALPHA 28 C = 170 - BlueHelix ALPHA 34 C = 200 G30/G31: - BlueHelix ALPHA 24 C = 176 - BlueHelix ALPHA 28 C = 165 - BlueHelix ALPHA 34 C = 188
P65	I paimplementuar	--	0
P66	Frekuenca e valvulit	0 - 1	0
P67	Valvuli i moskthimit (klapë) opsional	0 - 1	0
P68	Parametri i oxhakëve	0 ÷ 10 (modifikojeni sipas tabelës së oxhakëve)	0

Shënim:

1. Parametri i fuqisë maksimale mund të modifikohet edhe në modalitetin Test.

Për t'u kthyer në menunë e shërbimit, mjafton të shtypni butonin e risistemimit Reset. Dalja nga menuja e shërbimit të skedës bëhet duke shtypur butonin e risistemimit Reset për 10 sekonda ose automatikisht pas 15 minutash.

"In" - Menuja e informacioneve

Janë të disponueshme 12 informacione.

Duke shtypur butonat e ngrohjes mund të lëvizni nëpër listën e informacioneve, përkatësisht në rend rritës ose zbritës. Për të shfaqur vlerën, mjafton të shtypni butonat e ujit shtëpiak.

Treguesi	Përshkrimi	Diapazoni
t01	Sensori NTC i ngrohjes (°C)	0 ÷ 125 °C
t02	Sensori NTC i kthimit (°C)	0 ÷ 125 °C
t03	Sensori NTC i ujit shtëpiak (°C)	0 ÷ 125 °C
t04	Sensori NTC i jashtëm (°C)	+70 ÷ -30°C (Vlerat negative pulsojnë)
t05	Sensori NTC i tymrave (°C)	0 ÷ 125 °C
F06	Xhirot aktuale për minutë të ventilatorit	00 ÷ 120 x100RPM
L07	Fuqia aktuale e djegësit (%)	00%=Minimumi, 100%=Maksimumi
F08	Prurja aktuale e ujit shtëpiak (L min/10)	00 ÷ 99 Lt/min/10
P09	Presioni aktual i ujit të impiantit (bar/10)	00 = Me presostat të hapur, 12 = Me presostat të mbyllur, 00-99 bar/10 me shndërrues presioni
P10	Shpejtësia aktuale e pompës modulare (%)	00 ÷ 100%
P11	Orët e funksionimit të djegësit	00 ÷ 99 x 100 orë
F12	Gjendja e flakës	-- ÷ 255

Shënim:

1. Në rast se sensor i është i dëmtuar, skeda do të shfaqë vija të ndërprera.

Për t'u kthyer në menunë e shërbimit, mjafton të shtypni butonin e risistemimit Reset. Dalja nga menuja e shërbimit të skedës bëhet duke shtypur butonin e risistemimit Reset për 10 sekonda ose automatikisht pas 15 minutash.

“Hi” - Menuja e historikut

Skeda është në gjendje të memorizojë 8 anomalitë e fundit: E dhëna historike H1: përfaqëson anomalinë më të fundit që ka ndodhur; e dhëna historike H08: përfaqëson anomalinë më të vjetër që ka ndodhur.

Kodet e ruajtura të anomalive shfaqen edhe në menunë përkatëse të kronokomandës.

Duke shtypur butonat e ngrohjes mund të lëvizni nëpër listën e anomalive, përkatësisht në rend rritës ose zbritës. Për të shfaqur vlerën, mjafton të shtypni butonat e ujit shtëpiak.

Për t'u kthyer në menunë e shërbimit, mjafton të shtypni butonin e risistemimit Reset. Dalja nga menuja e shërbimit të skedës bëhet duke shtypur butonin e risistemimit Reset për 10 sekonda ose automatikisht pas 15 minutash.

“rE” - Risistemimi i historikut

Duke e shtypur butonin dimër/verë/Off-On për 3 sekonda, do të mund të anuloni gjithë anomalitë e memorizuara në menunë e historikut: skeda do të dalë automatikisht nga menuja e shërbimit, në mënyrë që të konfirmohet veprimi.

Dalja nga menuja e shërbimit të skedës bëhet duke shtypur butonin e risistemimit Reset për 10 sekonda ose automatikisht pas 15 minutash.

3.2 Vënia në punë**Përpara se të ndizni kaldajën**

- Kontrolloni mbylljen hermetike të implantit të gazit.
- Kontrolloni ngarkesën e duhur paraprake të enës zgjeruese.
- Mbusheni implantin hidraulik dhe garantoni një shfryrje të plotë të ajrit që përmban kaldaja dhe impianti.
- Kontrolloni nëse ka humbje uji në implant, në qarqet e ujit shtëpiak, tek lidhjet ose në kaldajë.
- Kontrolloni nëse ka lëngje apo materiale që marrin flakë, në afërsi të kaldajës.
- Kontrolloni që implanti elektrik dhe funksionimi i implantit të tokës të jenë lidhur saktë.
- Kryeni mbushjen e sifonit (shihni cap. 2.7).



NËSE UDHËZIMET E MËSIPËRME NUK RESPEKTOHEN MUND TË EKZISTOJË RREIKU I MBYTJES APO HELMIMIT NGA RRJEDHJA E GAZEVE APO TYMRAVE, RREZIK RËNIEJE ZJARRI OSE SHPËRTHIMI. GJITHASHTU EKZISTON RREZIKU I GODITJES ELEKTRIKE APO PËRMBYTJES SË DHOMËS.

Para ndezjes së kaldajës

- Sigurohuni që të mos ketë hapje të ujit të ngrohtë shtëpiak dhe kërkesa nga termostati i ambientit.
- Hapni gazin dhe verifikoni që vlera e presionit të ushqimit të gazit në rrjedhën e sipërme të pajisjes të jetë në përputhje me atë që ndodhet në tabelën e të dhënave teknike ose me tolerancën e parashikuar nga normativa.
- Ushqeni me energji elektrike kaldajën, në ekran do të shfaqet numri i versionit të softuerit e më pas **FH** dhe **Fh** cikli i shfryrjes së ajrit (shihni cap. 1.3 në page 6).
- Në përfundim të ciklit **Fh** në ekran do të shfaqet dritarja e modalitetit të dimrit (fig. 8), rregulloni temperaturat: prurja e ujit të ngrohjes dhe dalja e ujit të ngrohtë shtëpiak (fig. 12 dhe fig. 13). Verifikoni nëse vlera e parametrit të oxhakëve, **P68** - tabella 10 a pag. 29, është i përshtatshëm me gjatësinë e oxhakut të instaluar.
- Në rastin e ndryshimit të gazit (G20 - G30 - G31 - G230) verifikoni nëse parametri përkatës është i përshtatshëm me llojin e gazit që ndodhet në implantin e ushqimit (dhe cap. 3.1 në page 25).

- Kalojeni kaldajën në modalitetin e ujit shtëpiak ose të ngrohjes (shihnin cap. 1.3 në page 6).
- Në modalitetin e ngrohjes bëni një kërkesë: në ekran shfaqet simboli i radiatorit dhe temperatura aktuale e impiantit të ngrohjes.
- Modaliteti i ujit shtëpiak me hapjen e ujit të ngrohtë të pranishëm: në ekran shfaqet simboli i rubinetit dhe temperatura aktuale e ujit shtëpiak.
- Bëni verifikimin e djegies siç përshkruhet në paragrafin “Verifikimi i vlerave të djegies” on page 26.

3.3 Mirëmbajtja

PARALAJMËRIME



TË GJITHA PROCESET E MIRËMBAJTJES DHE ZËVENDËSIMET DUHET TË KRYHEN NGA PERSONEL I SPECIALIZUAR DHE ME KUALIFIKIM TË KONTROLLUAR.

Përpara se të kryeni çdo lloj procesi në brendësi të kaldajës, shkëputni ushqimin elektrik dhe mbyllni rubinetin e gazit në lartësi. Në të kundërt, mund të ekzistojë rreziku i shpërthimit, goditjes elektrike, asfiksimit ose helmimit.

Hapia e panelit të përparmë



Disa komponentë të brendshëm në kaldajë mund të arrijnë temperatura të larta, duke shkaktuar përvëlime të rënda. Para se të kryeni çfarëdolloj veprimi, prisni që këta komponentë të ftohen ose përndryshe, vishni doreza të përshtatshme.

Për të hapur kasën e kaldajës:

1. Zhvidhosni vidat "1" (shihni fig. 30).
2. Tërhiqeni panelin nga vetja dhe ngrijeni lart.





fig. 30- Hapja e panelit të përparmë



Në këtë pajisje, kasa e jashtme kryen edhe funksionin e dhomës hermetike. Pas çdo veprimi që ka të bëjë me hapjen e kaldajës, verifikoni me kujdes rimontimin e duhur të panelit të përparmë dhe mbylljen e tij hermetike.

Veproni në rend të kundërt, për të rimontuar panelin e përparmë. Sigurohuni që të kapet mirë në fiksuesit e sipërm dhe që të mbështetet plotësisht në anë. Koka e vidës "1", pasi është e ngjeshur, nuk duhet të jetë nën përthyerjen e poshtme të kthimit (shihni fig. 31).




fig. 31- Pozicioni i saktë i panelit të përparmë

Kontrolli periodik

Për të ruajtur në kohë funksionimin e saktë të pajisjes, është e nevojshme që një personel i kualifikuar të kryejë një kontroll vjetor që parashikon kontrollimet e mëposhtme:

- Mekanizmat komandues dhe ata të sigurisë (valvuli i gazit, flusometri, termostetet, etj.) duhet të funksionojnë si duhet.
- Qarku i shkarkimit të tymrave duhet të jetë në efikasitet të plotë.
- Dhoma hermetike duhet të jetë uthitur mirë.
- Kanalet dhe terminali i ajrit/tymrave duhet të mos kenë asnjë pengesë dhe të mos kenë rrjedhje.
- Djegësi dhe shkëmbyesi duhet të jenë të pastër dhe pa shtresë gëlqerore. Për pastrimin e mundshëm përdorni furça të përshtatshme. Mos përdorni në asnjë mënyrë produkte kimike.
- Elektroda duhet të mos ketë shtresa gëlqerore dhe duhet të jetë pozicionuar si duhet. Elektroda mund të pastrohet nga shtresat gëlqerore vetëm me furçë jometalike me qime të forta dhe NUK duhet ta kruani me letër smerile.
- Impiantet e gazit dhe të ujit duhet të jenë të mbyllura hermetikisht.
- Presioni i ujit të impiantit në të ftohtë duhet të jetë rreth 1 bar; nëse nuk është, rikthejeni në këtë vlerë.
- Pompa e qarkullimit nuk duhet të jetë e bllokuar.
- Ena zgjeruese duhet të jetë e ngarkuar.
- Prurja e gazit dhe presioni duhet të korrespondojnë me vlerat e dhëna në tabelat përkatëse.
- Sistemi i shkarkimit të kondensimeve duhet të jetë efikas dhe nuk duhet të ketë humbje ose pengesa.
- Sifoni duhet të jetë plot me ujë.
- Kontrolloni cilësinë e ujit të impiantit.
- Kontrolloni gjendjen e izolantit të shkëmbyesit.
- Kontrolloni lidhjen e gazit midis valvulit dhe venturit.
- Nëse nevojitet, në rast se dëmtohet, zëvendësoni guarnicionin e djegësit.
- Në përfundim të kontrollit, verifikoni gjithmonë parametrat e djegies (shihni "verifikimi i vlerave të djegies").

3.4 Zgjidhja e problemeve

Diagnostikimi

Ekrani LCD i fikur

Verifikoni nëse skeda ushqehet me energji elektrike: midis një multimetri dixhital, verifikoni nëse ka tension ushqyes.

Në rast se nuk ka një të tillë, verifikoni lidhjet e kabllave.

Në rast se ka tension të mjaftueshëm (gama 195 – 253 Vac), verifikoni gjendjen e siguresës (**3.15AL@230VAC**). Siguresa ndodhet në skedë. Për të hyrë, shihni fig. 19.

Ekrani LCD i ndezur

Në rast anomalish ose problemesh funksionimi, ekrani pulson dhe shfaqet kodi identifikues i anomalisë.

Ka anomali që shkaktojnë bllokime të përhershme (të cilësuar me germën "**A**"): për risistemimin e funksionit, mjafton të shtypni butonin e **risistemimit** (pjesa 6 - fig. 1) për 1 sekondë ose përmes butonit RESET të kronokomandës (opsionale), nëse instalohet; nëse kaldaja nuk rindizet, është e nevojshme të zgjidhet fillimisht anomalia.

Ka anomali të tjera që shkaktojnë bllokime të përkohshme (të cilësuar me germën "**F**") që risistemohen automatikisht sapo rivendoset vlera brenda fushës së funksionimit normal të kaldajës.

Tabela e anomalive**Tabella. 11- Lista e anomalive**

Kodi i anomalisë	Anomalia	Shkaku i mundshëm	Zgjidhja
A01	Djegësi nuk ndizet	Nuk ka gaz	Kontrolloni që fluksi i gazit në kaldajë të jetë i rregullt si dhe që të jetë eliminuar ajri nga tubacionet
		Anomali në elektrodën e detektimit/ndezjes	Kontrolloni kabllo e elektrodave nëse janë pozicionuar si duhet dhe nëse kanë shtresa gëlqerore dhe mundësisht, zëvendësoni elektrodën.
		Presioni i gazit të rrjetit i pamjaftueshëm	Verifikoni presionin e gazit të rrjetit
		Sifoni i bllokuar	Verifikoni dhe mundësisht pastroni sifonin
		Tubat e ajrit/tymrave të bllokuar	Zhblokoni oxhakun, tubat e daljes së tymrave, hyrjen e ajrit dhe terminalet.
		Tarim i gabuar	Bëni kalibrimin e plotë manual.
		Valvuli i gazit ka defekt	Verifikoni dhe nëse është nevojta zëvendësoni valvulin e gazit
A02	Sinjali i flakës shfaqet edhe kur djegësi është i fikur	Anomali në elektrodë	Kontrolloni kabllo e elektrodës së jonizimit
			Kontrolloni në elektroda është e plotë
			Elektroda e tokëzuar
			Kabëll i tokëzuar
F05	Anomali në ventilator	Anomali në skedë	Verifikoni dhe mundësisht pastroni sifonin
		Mungon tensioni i ushqimit 230V	Kontrolloni skedën
		Sinjali i takimetrit është ndërprerë	
A06	Pas fazës së ndezjes, nuk ka flakë	Ventilatori është dëmtuar	Verifikoni kabllo e konektorit me 5 pole
		Anomali në elektrodën e jonizimit	Verifikoni ventilatorin dhe nëse nevojitet, zëvendësojeni
		Flakë e paqëndrueshme	Kontrolloni pozicionin e elektrodës së jonizimit, pastroni shtresat e mundshme të gëlqerës dhe bëni një kalibrim të plotë manual, e nëse nevojitet, zëvendësoni elektrodën.
F15 - A07	Temperatura e tymrave e lartë	tubat e ajrit/tymrave të bllokuar	Kontrolloni shkëmbyesin
		Sifoni i bllokuar	Verifikoni sondën e tymrave
		Tarim i gabuar	Verifikoni parametrin e materialit të oxhakut
		Sonda e tymrave tregon temperaturë tejet të lartë	
A08	Ndërhyrje për mbrojtjen nga temperatura tejet e lartë	Sensori nuk është pozicionuar si duhet mbi tubin e prurjes ose është dëmtuar	Kontrolloni pozicionimin dhe funksionimin e sensorit të ngrohjes dhe nëse nevojitet, zëvendësojeni
		Uji nuk qarkullon në impiant	Kontrolloni qarkulluesin
		Në impiant ka ajër	Nxirrni ajrin nga impianti
A09	Ndërhyrje e mbrojtësit të shkëmbyesit	Uji nuk qarkullon në impiant	Verifikoni qarkulluesin dhe impiantin e ngrohjes
		Qarkullim i dobët dhe rritje anormale e temperaturës së sondës së prurjes	Nxirrni ajrin nga impianti
		shkëmbyesi i bllokuar	verifikoni shkëmbyesin dhe impiantin

Kodi i anomalisë	Anomalia	Shkaku i mundshëm	Zgjidhja
F09	Ndërhyrje për mbrojtjen nga temperatura tejet e lartë	Sensori i prurjes i dëmtuar	Kontrolloni pozicionimin dhe funksionimin e sensorit të prurjes dhe nëse nevojitet, zëvendësojeni
		Uji nuk qarkullon në impiant	Verifikoni qarkulluesin dhe impiantin e ngrohjes
		Në impiant ka ajër	Nxirri ajrin nga impianti
F10	Anomali në sensorin e prurjes	Sensori i dëmtuar	Kontrolloni kabllo ose zëvendësoni sensorin
		Kabllo janë në qark të shkurtër Kabllo kanë ndërprerje	
F11	Anomali në sensorin e kthimit	Sensori i dëmtuar	Kontrolloni kabllo ose zëvendësoni sensorin
		Kabllo janë në qark të shkurtër Kabllo kanë ndërprerje	
F12	Anomali në sensorin e ujit shtëpiak	Sensori i dëmtuar	Kontrolloni kabllo ose zëvendësoni sensorin
		Kabllo janë në qark të shkurtër Kabllo kanë ndërprerje	
F13	Anomali në sondën e tymrave	Sonda e dëmtuar	Verifikoni kabllo ose zëvendësoni sondën e tymrave
		Kabllo janë në qark të shkurtër Kabllo kanë ndërprerje	
A14	Ndërhyrje për sigurinë e tubit të daljes së tymit	Anomalia A07 e gjeneruar 3 herë në 24 orët e fundit	Shih anomalinë A07
F34	Tensioni i ushqimit më i ulët se 180V	Probleme me rrjetin elektrik	Kontrolloni impiantin elektrik
F35	Frekuenca e ushqimit e gabuar	Probleme me rrjetin elektrik	Kontrolloni impiantin elektrik
A23-A24-A26-F20 F21-F40-F47-F51	Anomali në presostatit e ujit	Parametri i konfiguruar në mënyrë të gabuar	Kontrolloni nëse parametri b04 është konfiguruar si duhet (standarde 0=presostat)
		Probleme me presionin e impiantit (shndërruesi)	Vlera e presionit të impiantit jashtë kufijve të konfiguruar (shndërruesi)
		b06 i konfiguruar në 3	
F37	Presioni i ujit në impiant jo i saktë	Presion tepër i ulët	Ngarkoni impiantin
		Presostati i ujit nuk është lidhur ose është i dëmtuar	Verifikoni presostatit e ujit
F39	Anomali në sondën e jashtme	Sonda e dëmtuar ose qark i shkurtër në kablo	Kontrolloni kabllo ose zëvendësoni sensorin
		Sonda e shpëputur pas aktivizimit të temperaturës së ndryshueshme	Rilidhni sondën e jashtme ose çaktivizoni temperaturën e ndryshueshme
F19	Anomali në parametrat e skedës	Konfigurim i gabuar i parametratit të skedës	Verifikoni dhe nëse nevojitet, modifikoni parametrin b15 në 3
F50 - F53	Anomali në termostatin limit me parametrin b06 = 1 ose 4	Qarkullimi i ujit mungon/është i dobët në impiant	Verifikoni qarkulluesin dhe impiantin e ngrohjes
		Në impiant ka ajër	Nxirri ajrin nga impianti
		Parametri i pasaktë	Verifikoni konfigurimin e saktë të parametratit
A64	Tejkalimi i numrit maksimal të rivendosjeve të njëpasnjëshme	Tejkalimi i numrit maksimal të rivendosjeve të njëpasnjëshme	Shkëputni ushqimin nga kaldaja për 60 sekonda e më pas risistemoni kaldajën
F62	Kërkohe kalibrim	Skedë e re ose kaldajë e paekuilibruar ende	Bëni kalibrimin e plotë manual
A88	Gabime specifike të kontrollit të djegies ose të valvulit të gazit	Aktivizimi i kalibrimit me djegës të ndezur. Problem me djegien, defekt në valvulin e gazit ose skedën elektronike	Rivendosni anomalinë dhe kryeni kalibrimin e plotë manual . Nëse nevojitet, zëvendësoni valvulin e gazit ose skedën elektronike.

Kodi i anomalisë	Anomalia	Shkaku i mundshëm	Zgjidhja
F65 ÷ F98	Gabime specifike të kontrollit të djegies	Tubat e tymrave të bllokuar. Presion i ulët i gazit. Sifoni i kondensimit i bllokuar. Problem djegieje ose riqarkullimi tymrash	Kontrolloni nëse tubat e tymrave dhe sifoni i kondensimit janë bllokuar. Kontrolloni presionin e saktë të ushqimit të gazit. Kryeni një kalibrim manual për të rregulluar CO₂. Nëse nevojitet, bëni kalibrimin e plotë manual. Nëse problemi vazhdon, zëvendësoni skedën elektronike.
A65 ÷ A97	Gabime specifike të kontrollit të djegies	Tubat e tymrave të bllokuar. Presion i ulët i gazit (A78 - A84). Sifoni i kondensimit i bllokuar. Problem djegieje ose riqarkullimi tymrash	Kontrolloni nëse tubat e tymrave dhe sifoni i kondensimit janë bllokuar. Kontrolloni presionin e saktë të ushqimit të gazit. Kryeni një kalibrim manual për të rregulluar CO₂. Nëse nevojitet, bëni kalibrimin e plotë manual. Nëse problemi vazhdon, zëvendësoni skedën elektronike.
A98	Shumë gabime SW ose gabim i evidentuar për zëvendësimin e skedës	Zëvendësimi i skedës Tubat e tymrave të bllokuar. Presion i ulët i gazit. Sifoni i kondensimit i bllokuar. Problem djegieje ose riqarkullimi tymrash.	Rivendosni anomalinë dhe vijoni me kalibrimin e plotë manual. Fillimisht zgjidhni problemin, rivendosni anomalinë dhe verifikoni ndezjen e saktë. Kryeni një kalibrim të plotë manual dhe nëse nevojitet, zëvendësoni skedën elektronike.
A99	Gabim i përgjithshëm	Gabim në harduer ose në softuerin e skedës elektrike	Rivendosni anomalinë dhe verifikoni ndezjen e saktë. Kryeni një kalibrim të plotë manual dhe nëse nevojitet, zëvendësoni skedën elektronike.
F96	Gabime specifike të djegies së flakës	Flakë e paqëndrueshme ose sinjali i flakës i paqëndrueshëm pas ndezjes.	Verifikoni ushqimin e gazit, tubat e tymrave dhe shkarkimin e kondensimit. Verifikoni pozicionin e duhur dhe gjendjen e elektrodës Pas rreth 3 minutash gabimi rivendoset.
A44	Gabim me kërkesat e shumëfishta	Kërkesa të përsëritura me kohëzgjatje të shkurtër	Verifikoni nëse ka rënie të presionit në qarkun DHW. Nëse nevojitet, modifikoni parametrin b11.
A80	Sinjali i flakës parazite pas mbylljes së valvulit	Problem tek elektroda. Problem në valvulin e gazit. Problem me skedën elektronike.	Verifikoni pozicionin e duhur dhe gjendjen e elektrodës. Verifikoni skedën elektronike. Verifikoni valvulin e gazit dhe nëse nevojitet, zëvendësojeni.

4. Karakteristikat dhe të dhënat teknike

4.1 Dimensionet dhe bashkimet

Modelet BlueHelix ALPHA 24 C dhe BlueHelix ALPHA 28 C




fig. 32- Pamja balllore




fig. 33- Pamja anësore




fig. 34- Pamja nga lart




fig. 35- Pamja nga poshtë

- 7 Hyrja e gazit - Ø 3/4"
- 8 Dalja e ujit shtëpiak - Ø 1/2"
- 9 Hyrja e ujit shtëpiak - Ø 1/2"
- 10 Prurja e impiantit - Ø 3/4"
- 11 Kthimi i impiantit - Ø 3/4"
- A6 Bashkimet e shkarkimit të ujit të kondensuar

Modeli BlueHelix ALPHA 34 C




fig. 36- Pamja balllore




fig. 37- Pamja anësore




fig. 38- Pamja nga lart




fig. 39- Pamja nga poshtë

- 7 Hyrja e gazit - Ø 3/4"
- 8 Dalja e ujit shtëpiak - Ø 1/2"
- 9 Hyrja e ujit shtëpiak - Ø 1/2"
- 10 Prurja e implantit - Ø 3/4"
- 11 Kthimi i implantit - Ø 3/4"
- A6 Bashkimet e shkarkimit të ujit të kondensuar

4.2 Pamja e përgjithshme




fig. 40- Pamja e përgjithshme

- 14 Valvuli i sigurisë
- 16 Ventilatori
- 32 Qarkulluesi i ngrohjes
- 34 Sensori i temperaturës së ngrohjes
- 36 Shfryrja e ajrit automatike
- 42 Sonda e temperaturës së ujit shtëpiak
- 44 Valvuli i gazit
- 56 Ena zgjeruese
- 81 Elektroda e ndezjes/ionizimit
- 95 Valvuli i devijatorit
- 114 Presostati i ujit
- 136 Flusometri
- 145 Hidrometri
- 186 Sensori i kthimit
- 191 Sensori i temperaturës së tymrave
- 193 Sifoni
- 194 Shkëmbyesi i ujit shtëpiak
- 196 Vrima e kondensimit
- 350 Grupi i djegësit/ventilatorit

4.3 Qarku hidraulik




fig. 41- Qarku hidraulik

- 8 Dalja e ujit shtëpiak
- 9 Hyrja e ujit shtëpiak
- 10 Prurja e implantit
- 11 Kthimi i implantit
- 14 Valvuli i sigurisë
- 32 Qarkulluesi i ngrohjes
- 34 Sensori i temperaturës së ngrohjes
- 36 Shfryrja e ajrit automatike
- 42 Sonda e temperaturës së ujit shtëpiak
- 56 Ena zgjeruese
- 74 Rubineti i mbushjes së implantit
- 95 Valvuli i devijatorit
- 114 Presostati i ujit
- 136 Flusometri
- 186 Sensori i kthimit
- 193 Sifoni
- 194 Shkëmbyesi i ujit shtëpiak
- 241 Devijimi automatik (brendësia e grupit të pompës)

4.4 Tabela e të dhënave teknike

Tabella. 12- Tabela e të dhënave teknike

E dhënë	Njësia	BlueHelix ALPHA 24 C	BlueHelix ALPHA 28 C	BlueHelix ALPHA 34 C	
KODET IDENTIFIKUES TË PRODUKTEVE		0TPF2AWA	0TPF4AWA	0TPF7AWA	
VENDET E DESTINACIONIT		AL			
KATEGORIA E GAZIT		-- (AL)			
Prurja termike maksimale e ngrohjes	kW	20,6	24,5	30,0	Q
Prurja termike minimale e ngrohjes	kW	4,2	4,8	5,0	Q
Fuqia termike maksimale e ngrohjes (80/60°C)	kW	20,0	24,0	30,0	P
Fuqia termike maksimale e ngrohjes (80/60°C)	kW	4,1	4,7	4,8	P
Fuqia termike maksimale e ngrohjes (50/30°C)	kW	21,8	26,0	31,9	
Fuqia termike maksimale e ngrohjes (50/30°C)	kW	4,5	5,0	5,4	
Prurja termike maksimale e ujit shtëpiak	kW	25,0	28,5	34,8	
Prurja termike minimale e ujit shtëpiak	kW	4,2	4,8	5,0	
Fuqia termike maksimale e ujit shtëpiak	kW	24,3	28,0	34,0	
Fuqia termike minimale e ujit shtëpiak	kW	4,1	4,8	4,8	
Rendimenti Pmax (80-60°C)	%	97,1	97,8	97,7	
Rendimenti Pmin (80-60°C)	%	97,0	97,6	97,2	
Rendimenti Pmax (50-30°C)	%	105,8	106,1	106,2	
Rendimenti Pmin (50-30°C)	%	106,9	107,3	107,1	
Rendimenti 30%	%	108,8	109,7	109,7	
Presioni i gazit ushqyes G20	mbar	20	20	20	
Prurja maksimale e gazit G20	m ³ /h	2,65	3,02	3,68	
Prurja minimale e gazit G20	m ³ /h	0,44	0,51	0,53	
CO ₂ - G20	%	9 ±0,8	9 ±0,8	9 ±0,8	
Presioni i gazit ushqyes G31	mbar	37	37	37	
Prurja maksimale e gazit G31	kg/h	1.94	2.21	2.70	
Prurja minimale e gazit G31	kg/h	0.33	0.37	0.39	
CO ₂ - G31	%	10 ±0,8	10 ±0,8	10 ±0,8	
Klasa e emetimit NOx	-	6	6	6	NOx
Presioni maksimal i ushtrimit të ngrohjes	bar	3	3	3	PMS
Presioni minimal i ushtrimit të ngrohjes	bar	0.8	0.8	0.8	
Temperatura maksimale e rregullimit të ngrohjes	°C	95	95	95	tmax
Përmbytja e ujit të ngrohjes	litri	3	3.4	4.3	
Kapaciteti i enës zgjeruese të ngrohjes	litri	8	8	10	
Presioni i ngarkesës paraprake të enës zgjeruese të ngrohjes	bar	0.8	0.8	0.8	
Presioni maksimal i ushtrimit të ujit shtëpiak	bar	9	9	9	PMW
Presioni minimal i ushtrimit të ujit shtëpiak	bar	0,3	0,3	0,3	
Prurja e ujit shtëpiak Dt 25°C	l/min	14,0	16,1	19,5	
Prurja e ujit shtëpiak Dt 30°C	l/min	11,7	13,4	16,2	D
Shkalla e mbrojtjes	IP	IPX4D	IPX4D	IPX4D	
Tensioni i ushqimit	V/Hz	230V/50Hz	230V/50Hz	230V/50Hz	
Fuqia elektrike e thithur	W	73	82	99	
Pesha në boshllëk	kg	27	27	31	
Tipi i pajisjes		C10-C11C13-C23-C33-C43-C53 C63-C83-B23-B33			

4.5 Diagrama

Epërsia e mbetur e disponueshme e impiantit

BlueHelix ALPHA 24 C




fig. 42- Epërsia e mbetur e disponueshme e impiantit

BlueHelix ALPHA 28 C




fig. 43- Epërsia e mbetur e disponueshme e impiantit

BlueHelix ALPHA 34 C




fig. 44- Epërsia e mbetur e disponueshme e impiantit

4.6 Skema elektrike

- | | |
|--|--|
| 16 Ventilatori | 114 Presostati i ujit |
| 32 Qarkulluesi i ngrohjes | 136 Flusometri |
| 34 Sensori i temperaturës së ngrohjes | 138 Sonda e jashtme (opsionale) |
| 42 Sonda e temperaturës së ujit shtëpiak | 139 Kronokomanda në distancë (opsionale) |
| 44 Valvuli i gazit | 186 Sensori i kthimit |
| 72 Termostati i ambientit (nuk ofrohet) | 191 Sensori i temperaturës së tymrave |
| 81 Elektroda e ndezjes/ionizimit | 288 Komploti antifriz |
| 95 Valvuli i devijatorit | A Çelësi ON/OFF (i konfigurueshëm) |




fig. 45- Skema elektrike



Kujdes: Përpara se të lidhni **termostatin e ambientit** ose **kronokomandën**, hiqni urën mbi morsetierë.

Në rast se doni të lidhni më shumë zona të impiantit hidraulik të kontrolluara nga termostati me kontakt të pastër dhe nëse nevojitet përdorimi i kronokomandës në funksionin telekomandues të kaldajës, është e nevojshme të lidhni kontaktet e pastra të zonave me morsetat 1-2 dhe kronokomandën me morsetat 5-6.

TË GJITHA LIDHJET ME MORSETIERËN DUHET TË JENË KONTAKTE TË PASTRA (JO 230V).



FERROLI S.p.A.
Via Ritonda 78/a
37047 San Bonifacio - Verona - ITALY
www.ferroli.com

Prodhuar ne Itali